

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6148
E hënë, 26 tetor 2020
çmimi 0.40 €

PDK-ja: Paralajmërimi i taksës
prej 10-eurosh për hyrje
në Prishtinë, dëshpërim



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ANALISTËT POLITIKË KANË KOMENTUAR PËRPLASJEN E FUNDIT NË MES TË
AVDULLAH HOTIT DHE RAMUSH HARADINAJT

ANALISTËT: ARSYEJA E VËRTETË E PËRPLASJES HOTI - HARADINAJ, POZITA E PRESIDENTIT

Njohësit e rrethanave politike në vend nuk besojnë se përplasja e fundit në mes të Avdullah Hotit dhe Ramush Haradinajt mund ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. Ata kanë deklaruar se arsyet e vërtetë të përplasjes së tyre janë pushteti dhe pozita e presidentit. Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për "Epokën e re" se vendin në zgjedhje mund ta çojë vetëm moszgjedhja e presidentit të ri. Ata kanë bërë me dije se do të jetë shumë e vështirë që partitë politike të bëjnë një marrëveshje për pozitën e presidentit



OPINION

ROLI DHE RËNDËSIA
E SHBA-SË NË BOTË F. 11

Shkruan:
Fehmi RAMA



AKTUALE



RUÇI ME AMBASADOREN E
KUBËS: KA ARDHUR KOHA TA
NJIHNI KOSOVËN F. 3

VAZHDON RITJA E NUMRIT TË
TË INFektUARVE ME COVID NË
KOSOVË F. 3

KRYETARËT E KOMUNAVE
FAJËSOJNË AVUK-un
PËR QENTË ENDACAKË F. 7

NË PRITJE TË LETËRNJOFTIMIT F. 6

EKONOMI

PRIVATIZIMI NË KOSOVË,
NËN HETIME F. 11

SPORT

TREPÇA '89 ARRIN FITORE TË
'ÇMENDUR' NDAJ BALLKANIT,
GJILANI MPOSHTI PRISHTINËN F. 14



FLET PËR "EPOKA E RE", SAMI MAZREKU

PANDEMIA DEMTOI SHUME BYRONË KOSOVARE TË SIGURIMIT

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Sami Mazreku, ka bërë me dije se ky institucion ka shënuar rënie të të hyrave si pasojë e reduktimit të lëvizjes së automjeteve, por edhe nga vendimi për zbritje të policave prej 35-përqindësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se reformimi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve është prioritet i tij. "Covid-19 ka dëmtuar rëndë sektorin e sigurimeve, por edhe Byronë Kosovare të Sigurimeve. Sipas të dhënave që kemi, shitja e policave ka rënë shumë", ka thënë Mazreku. Ai ka theksuar se

numri shumë i madh i automjeteve ta pasiguruara është shndërruar në kancer të sektorit të sigurimeve. "Aktualisht llogaritet se numri i automjeteve të pajegjistruara është më shumë se 150 mijë dhe dëmet që shkaktojnë këto automjete janë shumë të mëdha", ka thënë Mazreku

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ruçi me ambasadorën e Kubës: Ka ardhur koha ta njihni Kosovën

TIRANË, 25 TETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka pritur në takim ambasadorën e Kubës, Caidad Yaira Cueto Milian, me rastin e fillimit të detyrës së saj. Ruçi gjatë këtij takimi ka theksuar interesin e Shqipërisë për zgjerimin e marrëdhënieve dypalëshe përmes nxitjes së procesit të konsultimeve politike dhe bashkëpunimit në fushat e ekonomisë, shkëmbimeve tregtare, turizmit dhe kulturës. Po ashtu, ai kërkoi mbështetjen e Kubës për kandidaturën e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për vitet 2022-2023. Kryetari i Kuvendit të

Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka kërkuar gjithashtu që Kuba ta rishikojë qëndrimin e saj dhe ta njohë Republikën e Kosovës si dhe ta mbështesë anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Ambasadorja Caidad Yaira Cueto Milian ka shprehur dëshirën e Qeverisë së Kubës për zgjerimin e marrëdhënieve me Shqipërinë dhe ka premtuar mbështetjen e vendit të vet për kandidaturën e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për vitet 2022-2023. Ambasadorja Milian u shpreh se çështjen e njohjes së Kosovës do t'ia paraqesë Qeverisë së Kubës.



Kapet në Morinë trafikanti turk i drogës i shpallur në kërkim ndërkombëtar



TIRANË, 25 TETOR - Një trafikant droge turk, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Gjermania, është kapur në pikën e kalimit kufitar të Morinës. "Morinë, Kukës: Policia Kufitare kapi dhe ka vënë në pranga një shtetas turk të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Gjermania. Arrestimi provizor i tij u bë në bashkëpunim me Interpol Tiranën, me qëllim ekstradimin në shtetin gjerman. Në hyrje të Pikës së Kalimit Kufitar të Morinës,

shërbimet e Policisë Kufitare, si rezultat i masave të shtuara dhe shkëmbimit të informacionit me Interpol Tiranën, bën ndalimin e shtetasit të shpallur në kërkim ndërkombëtar: I. E., 42 vjeç, banues në Turqi", ka njoftuar Policia e Shqipërisë. Sipas këtij njoftimi, gjatë përpunimit dhe verifikimit të të dhënave në sistem, ky shtetas rezultoi person në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Wiesbaden, Gjermani.

"Autoritetet Gjyqësore Gjermane kanë caktuar ndaj tij masën e sigurisë 'Arrest me burg' për veprën penale 'Trafik droge', parashikuar nga Kodi Penal i Gjermanisë. Në përfundim të veprimeve hetimore, specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në DVP Kukës bën arrestimin provizor, me qëllim ekstradimin e tij drejt Gjermanisë", ka njoftuar policia.

Tirana të martën do ta organizojë takimin ministror rreth integritit të romëve

88 për qind e romëve në Ballkanin Perëndimor jetojnë në mungesë të rëndë materiale

Më 27 tetor në Tiranë do të organizohet takimi ministror mbi integrimin e romëve: "Strehimi, regjistrimi civil, mbledhja e të dhënave dhe buxhetimi në fokus". Takimin do ta hapë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, komisionari i BE-së, Oliver Varhelyi dhe sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu



TIRANË, 25 TETOR (ER) - Ministrat përgjegjës për integrimin e Romëve në ekonominë e Ballkanit Perëndimor do të takohen në Tiranë të martën për të diskutuar për përparimin e arritur në vitin e parë të zbatimit të Deklaratës për

Integrimin e Romëve, të miratuar në Samitin e Poznanit vitin e kaluar. Deklarata e Integritit të Romëve përcakton objektiva të rëndësishme që qeveritë duhet të arrijnë para se të mund të bashkohen me Bashkimin Evropian, pasi romët janë

anëtarët më të cenusur në rajonin tonë. 88 për qind e romëve në Ballkanin Perëndimor jetojnë në mungesë të rëndë materiale dhe 54 për qind nuk mund të siguronin ushqim çdo ditë dhe

kishin të paktën një anëtar të uritur të shtëpisë në muajin e kaluar.

Derisa përpjekja e përbashkët rajonale është e nevojshme për të përmirësuar jetën e Romëve, takimi do të mbledhë ministra

përgjegjës për Integrimin e Romëve nga ekonominë e Ballkanit Perëndimor, zyrtarë nga kabinetet e Kryeministrave, Pikat Kombëtare të Kontaktit të Romëve, organizatorët e Samitit të ardhshëm të Sofjes, si dhe përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe RCC (Këshillit për Bashkëpunim Rajonal). Ndër të tjera, temat e takimit ministror, i organizuar nga Qeveria e Shqipërisë dhe i bashkorganizuar nga Projekti i Integritit të Romëve të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), do të jenë: Strehimi, regjistrimi civil, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave dhe buxhetimi publik.

Vazhdon rritja e numrit të të infektuarve me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë vdekur dy viktime dhe janë shtuar edhe 186 raste të reja me Covid-19. Këto raste kanë ardhur pas testimit të 1 049 mostrave. Gjatë 24 orëve të fundit, IKShPK-ja ka njoftuar se janë shëruar edhe 54 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 088 raste, kurse numri i rasteve aktive me Covid është 2 192



EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 049 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 186 raste pozitive me Covid-

19. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me Covid. Numri total i rasteve pozitive është 17 943 raste nga 87 147 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 663 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 54 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 088 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 192. Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 72 raste, komuna Gjilan 20 raste,

komuna Fushë-Kosovë 17 raste, komuna Gjakovë 15 raste, komuna Vushtrri 9 raste, komuna Skenderaj 8 raste, komuna Pejë 7 raste, komuna

Ferizaj 6 raste, komuna Mitrovicë 6 raste, komuna e Lipjan 5 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Prizren 3 raste,

komuna Deçan 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Kamenicë, Klinë, Malishevë, Podujevë, Rahovec dhe Shtime.

Zemaj bën thirrje që të zbatohen masat anti Covid

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë thirrje që qytetarët të jenë kujdesshëm ndaj Covid-19 dhe ta mundësojnë funksionimin e hapur të shtetit për të gjithë. "Kemi dëshmuar se sa herë kemi qenë bashkë, kemi fituar. Andaj, edhe në luftë kundër

Covid-19, pashmangshëm do të dalim fitues! Të vazhdojmë fuqishëm, secili në përgjegjësitë që kemi, qeveria, policia, inspektoratet, spitalet, qytetarët dhe të gjithë aktorët e tjerë, bashkë kundër pandemisë", ka thënë Zemaj.

Ai ka theksuar se zëri i

ekspertëve duhet të vazhdojë të jetë zëri i vetëm që duhet të dëgjohet. "Vendimet e institucioneve duhet të respektohen dhe secili prej nesh t'i zbatojë ato. Ta mbrojmë veten dhe të afërmit, ta mbrojmë shëndetin publik dhe ta ndihmojmë shtetin. Shteti

duhet të jetë i hapur. Nxënësit duhet të vazhdojnë ta vijnë në mesimin në shkolla, bizneset duhet të vazhdojnë të punojnë, qytetari të mos varfërohet nga pamundësia për të punuar. Andaj, të jemi të kujdesshëm dhe ta mundësojmë funksionimin e hapur të shtetit për të gjithë",

ka deklaruar Zemaj.

Ministri Zemaj ka bërë thirrje që të zbatohen masat anti Covid-19. "Ndërsa për ata që shkelin masat anti Covid-19, duhet të zbatohet në përpikëri Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 nga organet e rendit", ka thënë Zemaj.

Kosova i bashkëngjitet Thirrjes Globale të Veprimit për Fuqizim Ekonomik të Grave

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Republika e Kosovës i bashkëngjitet Thirrjes Globale të Veprimit për Fuqizim Ekonomik të Grave, një iniciativë e ShBA-së për përkrahje të avancimit të pjesëmarrjes së plotë dhe të lirë të grave në ekonomi. Ministrja e Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se me nënshkrimin e Deklaratës së Thirrjes Globale të Veprimit për Fuqizim Ekonomik të Grave u është bashkuar homologëve nga shumë vende të botës për ta riafirmuar rolin e rëndësishëm që kanë gratë për përparim shoqëror dhe zhvillim ekonomik. "Përmes deklaratës nënvizohet fuqishëm rëndësia që ka mënjanimi i barrierave për

pjesëmarrje të plotë dhe të lirë të grave në ekonomi si dhe afirmohet roli i Republikës së Kosovës për ndërtimin e konsensusit ndërkombëtar për avancimin e fuqizimit ekonomik të grave. Përmes përkrahjes dhe bashkëngjites në këtë thirrje, Republika e Kosovës merr përsipër që të identifikojë dhe zhvillojë plane të brendshme për t'i avancuar reformat ligjore, rregullative dhe në nivel të politikëbërjes në fushat kryesore të cilat nxisin pjesëmarrjen e plotë dhe të lirë të grave në ekonomi, sigurimin e të drejtave pronësore dhe nxitjen e mundësive për të punuar në të njëjtat punë dhe sektorë sikurse dhe burrat", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla.



Analistët politikë kanë komentuar përplasjen e fundit në mes të Avdullah Hotit dhe Ramush Haradinajt

ANALISTËT: ARSYEJA E VËRTETË E PËRPLASJES HOTI - HARADINAJ, POZITA E PRESIDENTIT

Njohësit e rrethanave politike në vend nuk besojnë se përplasje e fundit në mes të Avdullah Hotit dhe Ramush Haradinajt mund ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. Ata kanë

deklaruar se arsyeja e vërtetë e përplases së tyre është pushteti dhe pozita e presidentit. Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për "Epokën e re" se vendin në zgjedhje

mund ta çojë vetëm moszgjedhja e presidentit të ri. Ata kanë bërë me dije se do të jetë shumë e vështirë që partitë politike të bëjnë një marrëveshje për postin e presidentit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 25 TETOR - Njohësit e rrethanave politike nuk i kanë marrë seriozisht përplasjet e fundit në mes të kryeministrit Avdullah Hoti dhe liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj, për çështjen e Taskë Forcës Anti-korrupsion. Ata kanë thënë se arsyeja e vërtetë e përplases mes partnerëve të koalicionit nuk është shpërbërja e Taskë Forcës Anti-korrupsion.

Analisti politik Imer Mushkolaj ka deklaruar për "Epokën e re" se arsyeja e vërtetë e mospajtimit në mes të Hotit dhe Haradinajt është pjesa për pushtet. "Në përplasjen e Hotit me Haradinaj, Taskë Forca është marrë vetëm si arsyetim. Sepse reagimi i Haradinajt ka ardhur disa ditë pasi është shfuqizuar Taskë Forca. Pra ai nuk reagoi ditën që u shfuqizua Taskë Forca. I janë dashur disa ditë derisa ta shfaqë kritikën e tij për këtë çështje. Unë besoj se Taskë Forca është vetëm arsyetim, ndërsa arsyeja e vërtetë e kësaj përplase është pikërisht pushteti, respektivisht përfitimet nga pushteti, sidomos tash kur Haradinaj nuk e ka të qartë se çka po ndodhë me postin e presidentit. Dhe kështu, duke e goditur Avdullah Hotin në mënyrë indirekte, Haradinaj po e godet Isa Mustafën", ka thënë Mushkolaj. Ai ka bërë me dije se lideri i LDK-së, Isa Mustafa, nuk i beson për postin e presidentit as PDK-së e as AAK-së. "Mendoj se Isa Mustafa nuk i beson as Haradinajt e as PDK-së në këtë kombinimin e ri që PDK-ja ta marrë presidentin, sepse frikësohet se posa ta marrë këtë post, PDK-ja mund ta prishë qeverinë ashtu siç ka ndodhur kur Thaçi është bërë president. Pra, Haradinaj po tregon mesazh se ai mund ta prishë qeverinë dhe mund ta çojë vendin në zgjedhje, mirëpo po duket se edhe LDK-ja nuk e ka problem këtë punë, sepse po shihet se edhe Isa Mustafa është



i interesuar të bëhet president dhe vendi të shkojë në zgjedhje. Se në çfarë kombinimesh mund ta arrijë këtë synim, tash pritet të shihet. Por qëllimi i të dyja palëve është i qartë", është shprehur ai.

Më tej, Mushkolaj ka vlerësuar se gjasat më të mëdha janë që vendi të shkojë në zgjedhje sesa dikush prej liderëve politikë të bëhet president i vendit. "Në këto rrethana ose do të shkojmë në zgjedhje ose do të kemi një president nga 'zarfi'. Pavarësisht se këto subjekte janë në

koalicion të përbashkët, ka një mosbesim të thellë në mes tyre, sidomos kur vjen puna të ndarja e posteve kryesore të shtetit. Unë besoj se më shumë ka gjasë që të shkohet në zgjedhje ose të gjendet një figurë që do të mund të bëhet president me pajtimin e partive politike sesa të jetësohet ajo formula që PDK-ja të hyjë në koalicion dhe posti i presidenti t'i takojë asaj", është shprehur Mushkolaj.

Edhe analisti tjetër politik Behxhet Shala ka thënë se

mospajtimet në mes të Hotit dhe Haradinajt janë teknike dhe taktike. "Kryeministri Hoti dhe z. Haradinaj kanë pasur mospajtime prej fillimit. Në fillim ato kanë qenë të heshtura dhe tek pastaj ato kanë dalë në sipërfaqe. Mendoj se këto mospajtime janë më tepër të natyrës teknike sesa një situatë e cila mund ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme, sepse as LDK-ja që është duke e udhëhequr qeverinë dhe as AAK-ja nuk janë të interesuara të shkojnë

në zgjedhje të parakohshme. Pra, kjo përplasje nuk besoj se mund të përfundojë me zgjedhje të reja", është shprehur Shala.

Ai ka thënë se vendin në zgjedhje të reja mund ta çojë vetëm çështja e zgjedhjes së presidentit të ri. "Në zgjedhje vendin mund ta çojë vetëm çështja e presidentit, pra nëse vihem në një situatë kur do të mungojë marrëveshje politike mes partive dhe nuk do të mund të zgjedhet presidenti. Përndryshe, këto

mosmarrëveshjet mes Hotit dhe Haradinajt nuk çojnë ndonjë peshë, sepse këso mosmarrëveshje kemi parë edhe më herët, dhe AAK-ja ka vazhduar të jetë pjesë e qeverisë”, ka thënë Shala. Ai ka vlerësuar se pretendimet e Haradinajt për ta marrë pozitën e presidenti janë legjitime. Sipas Shalës, Haradinaj po këmbëngul në këtë post, pasi e ka kuptuar se pa deputetët e kësaj partie nuk mund të zgjedhet presidenti i ri. “Të gjithë kanë të drejtë të kenë ambicie për president, nëse i plotësojnë kushtet e parapara me Kushtetutë. Z. Haradinaj më herët është deklaruar se është i duhuri për president. Pastaj

Osmani: Të mbijetuarat e dhunës seksuale në luftë janë viktimat të dyfishta

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka shkruar në llogarinë e vet në “Facebook” për të mbijetuarat e dhunës seksuale në luftë. Ajo ka thënë se të mbijetuarat e dhunës seksuale në luftë janë viktimat të dyfishta. “Së pari janë viktimë e vet krimin, së dyti viktimat të paragjyqimeve nga shoqëria, saqë një pjesë e madhe zgjedhin t’i vuajnë pasojat emocionale dhe traumatike në heshtje e izolim të plotë. E, mbi të gjitha, ato duan drejtësi. Këto gra nuk janë vetëm!”, ka shkruar Osmani. Ajo ka thënë se në njërin anë ato kanë mbështetjen e organizatave si Medica Gjakova, të cilën e vizituan këto ditë, të organizatave të tjera simotra që nuk reshtin së rezistuari çfarëdo presioni. “E, në anën tjetër, na kanë neve që përkulemi përpara qëndresës së pashoqe përballë dhimbjes dhe vuajtjes që ato përjetojnë. Por, ne mbështetësi



e tyre jemi ende të paktë në numër. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me mbështetje, por ka të bëjë me kuptimin e vërtetë të vuajtjes dhe pasojave shkatërruese shumëdimensionale të

luftërave. Të jemi aty për të mbijetuarit, do të thotë të jesh aty për t’u ballafaquar plotësisht me të kaluarën, për ta udhëhequr shoqërinë tonë drejt një rehabilitimi të shëndoshë,

solidar e me mirëkuptim të plotë për vuajtjet e brengat e secilës e secilit. Mbi të gjitha, të jesh me to do të thotë të kërkohet çdo ditë e me ngulm drejtësi”, ka shkruar Osmani.

Përplasja e Hotit dhe Haradinajt

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, që është partneri kryesor i kryeministrit Avdullah Hoti, të shtunën ka kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për shuarjen e Task Forcës Anti-korrupsion. Në një postim në rrjetin social “Facebook”, Haradinaj ka thënë se shkarkimi i kësaj force shkakton pasiguri juridike, pasi e njëjta ka hetuar dhe po hetonte raste të profilit të lartë. “Puna e tyre ka treguar që askush nuk është i paprekshëm nga drejtësia. Normalisht ka

pasur shumë gjëra të përmirësohen dhe kjo Task Forcë duhet të fuqizohet, qoftë nga rishikimi funksional ose nga rekomandimet e partnerëve strategjikë si ShBA-ja dhe BE-ja”, ka shkruar Haradinaj. I menjëhershëm ishte reagimi i kryeministrit Avdullah Hoti, i cili ka vlerësuar se qeveria është e vendosur për ta forcuar rendin ligjor dhe se siguria juridike garantohet vetëm duke respektuar Kushtetutën, ligjet dhe institucionet shtetërore. “Politika nuk duhet të përzihet në drejtësi. Këtë e kemi bërë me

vendimet që kemi marrë në këta muaj të qeverisjes. Drejtësia duhet ta bëjë punën sipas ligjit, e jo sipas vendimeve të qeverisë. Kthimi i ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në vend duhet të jetë angazhim i të gjithëve”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”. Qeveria e Kosovës një javë më parë vendosi ta mbyllë Taskë Forcën, duke vlerësuar se kjo çështje tash duhet të rregullohet me legjislacionin e funksionimit të Këshillit Prokurorial dhe se mandati i EULEX-it tashmë është ndryshuar.

zyrtarët e AAK-së janë deklaruar se ose do ta kenë presidentin ose do të shkojnë në zgjedhje. Çështja e presidentit nuk varet aq shumë

nga partitë politike të Kosovës sa varet nga vlerësimi se kush do të duhet të bëhet president. Duhet ta kemi parasysh se z. Thaçi, përveç që ka qenë

president, ai vetes i ka dhënë kompetenca që nuk i ka pasur asnjë president tjetër. Nëse e bëjmë një krahasim mes z. Thaçi dhe zonjës Jahjaga, është

një dallim tepër i madh”, është shprehur ai.

Ndërsa analisti tjetër, Belul Beqaj, mendon se ka ardhur koha që presidenti të zgjedhet me vota të drejtpërdrejta nga qytetarët e Kosovës. Sipas tij, mënyra aktuale e zgjedhjes së presidentit e ka shndërruar këtë post në instrument të kalkulimeve të partive politike. “Fatqësisht, presidenti është shndërruar si karrem zgjedhor dhe instrument i kalkulimeve politike. LDK-ja, përkatësisht Isa Mustafa, që e ka aktualizuar këtë para kohës, sot po thotë se nuk është koha të aktualizohet çështja e presidentit. Është koha që presidenti të zgjidhet me procedurë demokratike të drejtpërdrejtë ngaqë kështu si është, në vend se të jetë simbol i unitetit dhe stabilitetit, ai po paraqitet në rolin e pengesave dhe përçarjes politike”, ka vlerësuar Beqaj.

Veseli zbulon pllakën përkujtimore të UÇK-së në Bresanë të Sharrit

SHARRË, 25 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka zbuluar të dielën në Bresanë të Sharrit pllakën përkujtimore kushtuar luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai me këtë rast ka thënë se vajzat e djemtë më të shkëlqyer i dolën përballë

armikut sa herë që atdheu ishte në rrezik dhe kështu ndodhi edhe në Bresanë të Sharrit 21 vjet më parë. “Ashtu ishte edhe gjatë luftës sonë çlirimtare, kur rreshtat e njësiteve të UÇK-së, anekënd vendit, morën rrugën e pakthyeshme për liri. Bresana më 1999 ishte shndërruar në

fortesë lirie, ku 60 çlirimtarë u gjenden në shumë fronte dhe vijë të parë të luftimeve. Pllaka që nderon të gjithë pjesëtarët e UÇK-së, në Bresanë të Sharrit. Lavdi e përjetshme për heronjtë, dëshmorët dhe martirët e kombit!”, ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në “Facebook”.



Hoti paralajmëron mbledhje të përbashkët në mes të Qeverisë së Kosovës dhe të Maqedonisë

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije çështjet mbi të cilat ai dhe homologu i tij i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, janë pajtuar gjatë vizitës në Shkup. Hoti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se pika e përbashkët kufitare, ku lidhet autostrada Prishtinë-Shkup, gazsjellësi Shkup-Prishtinë, rruga Prizren-Tetovë, qendra e

përbashkët e skijimit, janë çështjet për të cilat janë pajtuar me kryeministrin Zaev. "Me kryeministrin Zaev u dakordua për: Pikën e përbashkët kufitare, ku lidhet autostrada Prishtinë-Shkup, gazsjellësin Shkup-Prishtinë, rrugën Prizren-Tetovë dhe qendrën të përbashkët skijimi. Këto dhe çështje të tjera diskutohen në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive", ka shkruar kryeministri Hoti.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka qëndruar të premtën për vizitë në Maqedoninë e Veriut, ku është pritur nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Hoti dhe Zaevi kanë vlerësuar raportet e deritanishme mes dy shteteve në të gjitha fushat, përfshirë edhe angazhimin e tyre në përbashkët me pandeminë Covid-19. Të dy kryeministrat gjatë këtij

takimi janë përqendruar në veçanti në projektet infrastrukturore, rritjen e bashkëpunimit tregtar si dhe përgatitjen për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët mes dy qeverive për konkretizimin e më shumë marrëveshjeve dypalëshe. "Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut ndajnë interesa të përbashkëta politike dhe ekonomike për stabilitetin, qëndrueshmërinë

dhe prosperitetin e rajonit tonë. Fuqizimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe fqinjësisë së mirë është përkushtimi ynë dhe nuk ka alternativë tjetër", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se Prishtina do t'i ndjekë përvojat e Maqedonisë së Veriut për realizimin e reformave në ekonomi, por edhe për arritjen e marrëveshjeve me shtetet fqinje që garantojnë paqe dhe stabilitet në rajon.



Në pritje të letërnjoftimit

PRISHTINË, 25 TETOR - Në gjysmën e muajit gusht A. N. nga një fshat i Prizrenit (emër i njohur për redaksinë) kishte aplikuar për t'u pajisur me letërnjoftim të ri të Kosovës, pasi i kishte skaduar letërnjoftimi i vjetër. Por, ai dhe shumë qytetarë të tjerë të Kosovës nuk kanë mundur të pajisen me këtë dokument për shkak të mungesës së materialit për të prodhuar letërnjoftim. Mungesë ka pasur në të gjitha komunat. Duke e pasur të domosdoshëm letërnjoftimin, ai u detyrua që dy muaj më vonë të aplikonte përsëri për t'u pajisur me këtë dokument. Por, këtë herë kishte aplikuar përmes procedurës së shpejtë. "Më 13 gusht kam aplikuar për letërnjoftim. Nuk ka dalë. Pastaj jam detyruar të aplikoj me procedurë të shpejtë. Kur shkoja në qendër të regjistrimit,

më thoshin nuk ka material. Jam detyruar të paguaj edhe 50 euro shtesë për ta marr letërnjoftimin", thotë ai. Agon Hysaj nga Demokraci Plus thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vonesat për t'u pajisur me letërnjoftime dhe pasaporta po u shkaktojnë qytetarëve probleme. Hysaj thotë se edhe pasaportat e skaduar nuk mund të vazhdojnë dhe qytetarët rrjedhimisht nuk mund të udhëtojnë jashtë vendit. "Ministria e Punëve të Brendshme është arsyetuar se nga rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë nuk ka arritur që t'i kryejë me kohë procedurat e prokurimit për këtë furnizim, mirëpo ky nuk është një arsyetim i pranueshëm, pasi pandemia është edhe tani në mesin tonë dhe furnizimi me letërnjoftime dhe pasaporta është çështje

shumë e ndjeshme dhe nuk qytetarët mund të penalizohen për faj të institucionit", thotë Hysaj. Tenderin për furnizim me letërnjoftime dhe pasaporta për vitin 2020-2021 tashmë e ka fituar kompania e njëjtë që ka bërë furnizimin deri më tash. Ka disa vjet që furnizimin me letërnjoftim e bënë kompania gjermane "Veridos", që ka selinë në Kosovë. Sipas kontratës, kompania fituese do ta

furnizojë ministrinë me 250 mijë letërnjoftime elektronike dhe me 50 mijë pasaporta. Mbi 1 milion e 200 e mijë euro do t'i kushtojë Ministrisë së Punëve të Brendshme furnizimi me këto materiale. "Radio Evropa e Lirë" ka provuar të marrë një përgjigje nga kjo ministri për të mësuar se kur do të fillojnë qytetarët të marrin letërnjoftimet e reja, por nuk është përgjigjur. Më herët gjatë këtij muaji, ministri i Brendshëm, Agim

Veliu, kishte thënë në Kuvendin e Kosovës se "në qershor të vitit 2019 kanë kërkuar buxhet nga Ministria e Financave për dokumente, por që nuk është bërë ndarja e buxhetit". Sipas Veliut, MPB kërkesë për buxhet shtesë kishte bërë edhe në muajin shkurt, por nuk është aprovuar.

Në fillim të muajit të kaluar Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi qytetarët e Republikës së Kosovës, se nga rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19, Agjencia e Regjistrimit Civil nuk ka arritur me kohë të duhur t'i kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për furnizim me material të mjaftueshëm për letërnjoftime. Si pasojë, shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët kanë aplikuar për letërnjoftim, nuk kanë arritur që të pajisen në kohën e paraparë.



PDK-ja: Paralajmërimi i taksës prej 10-eurosh për hyrje në Prishtinë, dëshpërim

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë, Bujar Cakolli, ka thënë se margaritari i fundit i modelit qeverisës të Lëvizjes Vetëvendosje, paralajmërimi për ta vendosur taksën e hyrjes në Prishtinë për banorët e qyteteve të tjera, është një përpjekje e dëshpëruar për të mbledhur një grusht votash

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë kanë mbajtur të dielën konferencë për media, në të cilën kanë folur për gjendjen e transportit publik në kryeqytet dhe për idenë e vendosjes së taksës për hyrje ditore në Prishtinë.

Zyrtarët e Degës së PDK-së në Prishtinë kanë shprehur shqetësimin për paaftësinë menaxhuese të udhëheqjes komunale, e cila, sipas tyre, me papërgjegjësinë e saj e ka shndërruar kryeqytetin në një hapësirë kaotike pothuajse të pajetueshme.

Nënkryetari i PDK-së në Prishtinë, Bujar Cakolli, ka thënë se modeli i organizimit të trafikut urban dhe transportit publik ka mbetur i tillë që nga koha e qeverisjes së Ismet Beqirit në Prishtinë, ndonëse Lëvizja Vetëvendosje në të dyja fushatat zgjedhore kishe premtuar zgjidhje sipas modeleve të avancuara evropiane, e në fakt kjo u minimizua vetëm në blerjen me kredi të disa autobusëve. "Margaritari i fundit i modelit qeverisës të LV-së, paralajmërimi për ta

vendosur taksën e hyrjes në Prishtinë për banorët e qyteteve të tjera, është një përpjekje e dëshpëruar dhe e dështuar për të mbledhur një grusht votash. As qaq nuk do të jetë efekti i saj ngaqë Prishtina është e prishinasve, por është edhe kryeqendra e gjithë Kosovës, jo vetëm administrative, por edhe biznese. Duke qëndruar në Prishtinë, banorët e qyteteve të tjera i lënë asaj dhe bizneseve të saj një përqindje të lartë fitimi", ka thënë Cakolli.

Deputetja e PDK-së në Kuvendin e Kosovës, Eliza Hoxha, ka konsideruar se taksa është hapi i fundit në menaxhimin e lëvizshmërisë brenda një qyteti atëherë kur të gjitha hallkat janë në funksion dhe qytetarët pa dallim kanë një mori alternativash dhe mundësish për të lëvizur në qytet dhe jashtë tij. "Kur jemi te mobiliteti dhe infrastruktura lirisht mund të themi se të gjitha rrugët shpijnë në Prishtinë. Partia Demokratike e Kosovës sa ishte në pushtet në nivelin qendror ka realizuar një mori projektesh infrastrukturorë në nivel vendi, autostradat si dhe zgjerimin dhe trajtimin e rrugëve regjionale që Prishtina të jetë e lidhur sa më mirë me të gjitha qytetet e tjera", ka thënë ajo.



Midis shumë premtimeve të parealizuara nga qeverisja aktuale, deputetja Hoxha ka përmendur mosrealizimin e rrugës A, dështimin e krijimit të sistemit të integruar të biletave, moslirimin e studentëve nga pagesa dhe ndërtimin e një stacioni modern të autobusëve. Sipas saj, të thirresh në taksë për me pak makina e më pak ndotje në qytet e të ndërtosh parking me 700 njësi parkimi në qendër

të qytetit është absurde. Ajo ka treguar se shqetësim të njëjtë ka edhe për këmbësorët. "Ecja në këmbë vazhdon të jetë mision i pamundur, por edhe ajo me biçikletë. Krijimi i shtigjeve të reja për çiklistë në dëm të hapësirës, trotuarit për këmbësorë siç është rasti te ndërtesa e KEDS e tutje, po ashtu tregon për qasje përjashtuese", ka thënë Eliza Hoxha, duke shtuar se Prishtina nuk duron

më këso veprime ad-hoc dhe qasje përjashtuese të vazhdueshme varësisht nga agjendat e aktorëve qeverisës. Sipas Hoxhës, mungesa e vizionit të të dy subjekteve qeverisëse deri tani e ka shndërruar Prishtinën në qytetin ku çdokush vjen të marrë atë që i takon dhe mundohet sa më shpejt të ikë nga ajo për shkak të zhurmës, ndotjes, presionit psikologjik dhe nervozes.

Kryetarët e komunave fajësojnë AVUK-un për qentë endacakë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetarët e komunave të Kosovës edhe një herë kanë kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AVUK) që seriozisht të merret me trajtimin e qenve endacakë. Sipas kryetarëve të komunave, përgjegjësinë për qentë endacakë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me buxhet shtesë në vlerë miliona euro që nga viti 2018, e ka marrë dhe vazhdon ta ketë AVUK. "Që në atë kohë, në takimet e ndryshme që kryetarët e komunave kanë zhvilluar me institucionet relevante, ku është kërkuar zgjidhja e problemit me qentë endacakë, është konstatuar që ky problem nuk mund të zgjidhet komunë për komunë ndaras, por është kërkuar zgjidhje në nivel vendi", thuhet në komunikatën e

Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK).

Për këtë arsye, sipas AKK-së, AVUK si institucion qendror ka marrë përgjegjësi që të merret me trajtimin e këtij problemi në nivel vendi. Për këtë, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë buxhet shtesë AVUK-ut (buxhet me miliona euro) që të merret me trajtimin e qenve endacakë. "Duhet theksuar se baza ligjore e bën përgjegjës AVUK që të kujdeset për shëndetin dhe kontrollimin e kafshëve në Kosovë (konsiderohet që edhe qentë janë kafshë), siç është përkrahur në Ligjin 2004/21 dhe Ligjin 02/21 dhe bazuar në këtë ligj, AVUK ka të krijuar edhe sektorë brenda saj dhe ka zyrtarë shtetërorë që merren me mirëqenien e kafshëve", thuhet në komunikatë.

Më tej se kryetarët e komunave kërkojnë nga AVUK zbatimin e



plotë të zotimeve të tyre që burojnë nga projekti disavjeçar, projekt ky i cili ka planin konkret të veprimit disavjeçar, i përcjell me buxhet shtesë. "Duhet theksuar që ky projekt është hartuar në bashkëpunim

me komunat e Kosovës dhe me ambasadën amerikane, i përkrahur financiarisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2018. Kjo është zgjidhja e problemit dhe jo akuza ndaj komunave.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në ditët në vijim do ta deponojë kërkesën mbi qasjen në dokumente zyrtare në AVUK sa i përket zbatimit të projektit në fjalë", thuhet në komunikatën e AKK-së.

Flet për “Epoka e re”, Sami Mazreku

Pandemia dëmtoi shumë Byronë Kosovare të Sigurimit

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Sami Mazreku, ka bërë me dije se ky institucion ka shënuar rënie të të hyrave si pasojë e reduktimit të lëvizjes së automjeteve, por edhe nga vendimi për zbritje të policave prej 35 përqindësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se reformimi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve është prioriteti i tij. “Covid-19 ka dëmtuar rëndë sektorin e sigurimeve, por edhe Byronë Kosovare të Sigurimeve. Sipas të dhënave që kemi, shitja e policave ka rënë shumë”, ka thënë Mazreku. Ai ka theksuar se numri shumë i madh i automjeteve ta pasiguruara është shndërruar në kancer të sektorit të sigurimeve. “Aktualisht llogaritet se numri i automjeteve të pargjistruara është më shumë se 150 mijë dhe dëmet që shkaktojnë këto automjete janë shumë të mëdha”, ka thënë Mazreku



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË 25 TETOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Sami Mazreku, ka thënë se është shënuar rënie e të hyrave si pasojë e reduktimit të lëvizjes së automjeteve, por edhe nga vendimi për zbritje të policave prej 35 përqindësh. “Përpos që të hyrat kanë rënë si pasojë e reduktimit të lëvizjes, të hyrat kanë rënë edhe nga vendimi për zbritje të policave prej 35 përqindësh me vendimin e qeverisë për mbulim të tyre deri në fund të këtij viti. Po ashtu, te pagesa e faturave nga ana e qeverisë ka vonesa të pagesës së mjeteve dhe kjo drejtpërdrejt është duke ndikuar në punën e Byrosë”, ka thënë Mazreku në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”.

Ai ka treguar se te pagesa e faturave nga ana e qeverisë është duke pasur vonesa të pagesës së mjeteve, gjë që kjo po ndikon drejtpërdrejt edhe në punën e Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Mazreku ka thënë se ka një plan dinamik të punës në krye të këtij institucioni ku, sipas tij, implementimi i këtij plani do të nisë në ditët në vijim. “Reformimi i Byrosë është prioriteti kryesor imi por, siç e thashë edhe në përgjigjen paraprake, në ditët dhe muajt në vijim ne do ta zbatojmë planin e hartuar. Aktualisht Byroja nuk është në gjendje të mirë financiare, pasi që nga muaji mars i këtij viti, kur janë shfaqur edhe te ne rastet e para me Covid-19, shitja e policave thuhet se ka

rënë tërësisht. Një situatë e tillë ka vazhduar edhe në muajt pasues”, ka deklaruar Mazreku. Ai ka thënë se numri shumë i madh i automjeteve të pasiguruara është shndërruar në kancer të sektorit të sigurimeve. “Aktualisht llogaritet se numri i automjeteve të pargjistruara është më shumë se 150 mijë dhe dëmet që shkaktojnë këto automjete janë shumë të mëdha”, ka thënë ushtruesi i detyrës i drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Sami Mazreku.

“Epoka e re”: Z. Mazreku, tani jeni në krye të Byrosë Kosovare të Sigurimeve si ushtrues i drejtorit. Çfarë hapash janë shënuar nga ardhja juaj në Byro?

Mazreku: Më 1 tetor të këtij viti, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme jam emëruar ushtrues i detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Pasi që bëhet fjalë për një kohë të shkurtër prej kur unë kam marrë këtë mandat, ende nuk kam arritur ta kem një pasqyrë të saktë për gjendjen në këtë institucion. Si do që të jetë, unë kam hartuar një plan shumë dinamik të punës i cili do të implementohet në ditët dhe në muajt në vijim. Si në asnjë institucion tjetër, Covid-19 ka dëmtuar rëndë sektorin e sigurimeve, edhe Byronë Kosovare të Sigurimeve. Sipas të dhënave që kemi, shitja e policave ka rënë shumë.

“Epoka e re”: Çfarë prioritetesh keni sa i përket këtij sektori?

Mazreku: Reformimi i Byrosë është prioriteti im kryesor por, siç e thashë edhe në përgjigjen

paraprake, në ditët dhe muajt në vijim ne do ta zbatojmë planin e hartuar. Aktualisht Byroja nuk është në gjendje të mirë financiare, pasi që nga muaji mars i këtij viti kur janë shfaqur edhe te ne rastet e para me Covid-19, shitja e policave thuajse ka rënë tërësisht. Një situatë e tillë ka vazhdat edhe në muajt pasues.

“Epoka e re”: Cila është pasqyra në BKS sa iu përket të hyrave marrë parasysh që policat e sigurimeve u mbuluan nga qeveria deri në fund të këtij viti? **Mazreku:** Përpos që të hyrat kanë rënë si pasojë e reduktimit të lëvizjes, të hyrat kanë rënë edhe nga vendimi për zbritje të policave prej 35-përqindësh me vendimin e qeverisë për mbulim të tyre deri në fund të këtij viti. Po ashtu, te pagesa e faturave nga ana e qeverisë po ka vonesa të pagesës së mjeteve dhe kjo drejtpërdrejt është duke ndikuar në punën e Byrosë. Ta zëmë, kur bëhet pagesa, qeveria bazohet në numrin e automjeteve që blejnë polica drejt në pika kufitare, por mos të harrojmë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, përpos që blejnë policë në pikë kufitare, kur t’i skadojë ajo, ata e vazhdojnë atë në zyrat e Byrosë. Që nënkupton se nuk kalojnë nëpër pikat kufitare, pra nëpër kamerat e sigurisë në pikat kufitare, gjë që mund të shkaktojë mospërputhje të numrave të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të dhënat tona reale, e që po shkakton probleme dhe vonesa në pagesa të mjeteve.

“Epoka e re”: Na tregoni për sfidat e tjera me të cilat po përballen BKS-ja?

Mazreku: Rënia e të hyrave aktualisht është sfida kryesore me të cilën po përballemi aktualisht, por shpresojmë për përfundim sa më të shpejtë të pandemisë dhe kthim të jetës normale.

“Epoka e re”: Është potencuar disa herë si problematik numri i lartë i automjeteve të paregjistruara, si pengesë për anëtarësim në Kartonin e Gjellbër. A keni ndonjë plan konkret se si të bjerë ky numër?

Mazreku: Numri shumë i madh i automjeteve të pasiguruara, siç e kam thënë edhe shumë herë më parë, është shndërruar në kancer të sektorit të sigurimeve. Aktualisht llogaritet se numri i automjeteve të paregjistruara është më shumë se 150 mijë dhe dëmet që shkaktojnë këto automjete janë shumë të mëdha. Në bazë të ligjit qytetarët që janë të dëmtuar nga këto automjete duhet të kompensohen nga Byroja, e në anën tjetër rimbursimi i këtyre mjeteve që qytetarët kanë shkaktuar dëme është shumë i vështirë.

“Epoka e re”: Marrë parasysh rrethanat aktuale, kur pritet të anëtarësohemi në Kartonin e Gjellbër? Dhe a jeni në bisedime me ndonjë shtet që mund të garantojë për Kosovën?

Mazreku: Qëllimi i të gjithëve është anëtarësimi i Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjellbër, por për të arritur deri këtu kemi shumë punë para vetes. Besoj se me një angazhim të madh do të arrijmë të jemi pjesë e këtij institucioni.

Kurtishaj: Qytetarët e Shqipërisë për pushimet vjeshtë - dimër ta kenë destinacion kryesor Kosovën

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetari i Shoqatës së Transportit Rrugor dhe Turizmit, Ruzhdi Kurtishaj, ka folur rreth vizitës së grupit të parë të turistëve nga Shqipëria me moton “Pusho shqip”. Në një bisedë për gazetën “Epoka e re”, Kurtishaj ka thënë se në aspektin e bashkëpunimit me Shqipërinë më tepër është duke u bërë nga partneriteti privat sesa nga ai institucional. “Ky ekskursion ishte vazhdimësi e bashkëpunimit tonë me Shqipërinë. Është mirë që partneriteti privat po ecën më mirë sesa partneriteti në mes të institucioneve. Jam shumë i lumtur dhe krenar që grupi prej 60 personash ka vizituar Kosovën falë bashkëpunimit të mirë që kemi pasur”, ka thënë Kurtishaj, duke shtuar se kjo vizitë e personave nga Shqipëria

ishte një kthim i borxhit moral. “Kjo është një mesazh për të gjithë në Shqipëri se duhet ta vizitojnë Kosovën dhe nga afër të njoftohen për zhvillimet që kanë ndodhur në Kosovë. Thirrja jonë për të gjithë vëllezërit në Shqipëri është që ta vizitojnë Kosovën sepse vendi ynë ka potencial për turizëm vjeshtë - dimër. T’i lënë pak anash vendet e regjionit, sepse e kanë Prishtinën, Prizrenin, Dukagjinin dhe shumë vende të tjera”, është shprehur Kurtishaj. Ai më tutje ka thënë se kjo vizitë ishte mbresëlënëse dhe se ka shpresa që do të vazhdojë kjo traditë. “Vizita e tyre ishte mbresëlënëse. Disa e vizitonin Kosovën për herë të parë. Kështu që, përshtypjet ishin pozitive dhe shpresat janë që do ta vazhdojnë këtë traditë”, u

shpreh ai.

Kurtishaj ka thënë se, pavarësisht prej rrethanave të pandemisë, assesit s’bën që të mbyllet kufiri me Shqipërinë. “Pandemia e ka goditur çdo vend, por Kosova dhe Shqipëria, falë nismës së marrë nga ministri i Turizmit të Shqipërisë, z. Blendi Klosi, u bë zë për moton ‘Pusho shqip’. Kemi arritur që mos ta bllokojmë turizmin. Prandaj, mbyllja s’do të ishte zgjidhje. Çdoherë kam qenë kundër mbylljes së kufijve me shtetin amë dhe askush s’duhet ta mendojë më këtë opsion”, ka thënë më tutje Kurtishaj, duke shtuar se sa i përket kalimit transit, janë rregullat e caktuara nga OBSH-ja. “Mbyllja duhet t’i kalojë të kaluarës dhe s’duhet të bëhet fjalë më për të”, ka thënë ai.



Qeveria shkarkon bordin e përkohshëm të KEK-ut

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ka mbajtur mbledhje korresponduese (mbledhje elektronike), të 37-n me radhë. Në këtë mbledhje është miratuar vendimi për shkarkimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike “Korporata Elektroenergjetike e Kosovës KEK” Sh. A. dhe për emërimin e Bordit të Përkohshëm. “Ky vendim shfuqizon Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/19 të datës 03.08.2020. dhe emëron Bordin e Përkohshëm të N. P.



‘Korporata Elektroenergjetike e Kosovës - KEK’ Sh. A. në këtë përbërje: 1. Musa Misini - kryesues, drejtor; 2. Petrit

Ibraj, drejtor; 3. Fatime Grajcevc, drejtoresh; 4. Fadil Hoxha, drejtor”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Gjendet e gjallë 26-vjeçarja nga Skenderaj

SKENDERAJ, 25 TETOR (ER) - Është gjetur e gjallë 26-vjeçarja Egzona Ferati nga Komuna e Skenderajt, e cila ditë më parë ishte raportuar e zhdukur. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se ajo është gjetur në fshatin Gllanasellë dhe se ekipi mjekësor në Drenas ia ka dhënë ndihmën e parë, e me pas është dërguar për trajtim në QKUK. "Lajm i mrekullueshëm! Egzona Islam Ferati është gjetur e gjallë

në fshatin Gllanasellë. Tani ekipi mjekësor do ta ofrojë ndihmën e parë dhe do të na njoftojë për gjendjen e saj shëndetësore. Një falënderim i madh për të gjithë qytetarët e vullnetit të mirë që sot kërkuar dhe gjetën Egzonën", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa doktoresha Dafina Basholli ka theksuar se gjendja e Feratit për momentin është stabile. "Pacientja në fillim ka ardhur e vetëdijshme, por jo

komunikuese me një hipertermi, pasi kishte qëndruar për një kohë të gjatë në këto temperatura të ftohta. Pacientja kishte një puls të zvogëluar. Pas terapisë së marrë, tani gjendja është më stabile, është ngritur temperatura trupore dhe pulsi është rregulluar", ka thënë ajo. Basholli ka thënë se trajtimi i saj do të vazhdojë, pasi po presin edhe analizat laboratorike dhe ekzaminime të tjera.



Dita e diel vazhdon të jetë ditë pushimi për bizneset në Mitrovicë



MITROVICË, 25 TETOR (ER) - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar të gjitha subjektet afariste që operojnë në këtë qytet, se dita e diel do të vazhdojë të jetë ditë pushimi, deri në momentin e konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal të datës 24.09.2020. Kjo pasi që MAPL-ja me datë 02.10.2020 iu

ka drejtuar me shkresë përcjellëse Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ku ka kërkuar që ta shqyrtojnë kërkesën e ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal, që dita e diel të rikthehet si ditë e rregullt e punës për të gjitha bizneset. Andaj derisa nuk marrim ndonjë përgjigje nga Ministria gjegjëse, Komuna e

Mitrovicës nuk do ta zbatojë këtë vendim sepse konsiderohet jo i ligjshëm. Me këtë rast, Drejtoria e Inspeksionit bën me dije që inspektorët komunalë edhe këtë të diel do t'i inspektojnë të gjitha bizneset në respektimin e orarit të punës sipas Rregullores komunale nr. 03/2014.

Nis asfaltimi i rrugës 'Arkitekt Karl Gega' në Prishtinë

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka filluar asfaltimi i rrugës "Arkitekt Karl Gega" në kryeqytet. Kjo komunë ka bërë me dije se punimet do të vazhdojnë edhe në asfaltimin e rrugës "Gazmend Zajmi". "Kanë filluar punimet e asfaltimit në rrugën 'Arkitekt

Karl Gega', deri tek udhëkryqi i rrugës 'Ali Pashë Tepelena'. Punimet do të vazhdojnë edhe në asfaltimin e rrugës 'Gazmend Zajmi' dhe pritet të përfundojnë sipas planifikimeve", ka njoftuar Komuna e Prishtinës, e cila drejtohet nga Shpend Ahmeti.



Violeta Dema rizgjedhet kryetare e Forumit të Gruas së Nismës në Gjakovë

GJAKOVË, 25 TETOR (ER) - Të dielën është mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Forumit të Gruas së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, ku nga delegatet e pranishme kryetare u rizgjodh Violeta Dema. Nën kryetare e parë e Forumit të Gruas së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë është zgjedhur Hasbije Godanci, kurse sekretare Valdete Rrahmani. Kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, Fazli Hoxha, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka thënë se angazhimi i gruas në politikë është i domosdoshëm. Sipas Hoxhës, Nisma Socialdemokrate brenda saj dhe qeverisjes qendrore e lokale është duke rritur në vazhdimësi numrin e grave në

vendimmarrje. "Forumi i Gruas së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë që nga themelimi ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në fuqizimin dhe rritjen e Nismës Socialdemokrate si dhe në angazhimin e saj politik, ekonomik dhe social, për një mirëqenie më të mirë për qytetarët e Gjakovës. Këtë forum me pjesëmarrje e nderuan edhe përfaqësues të Nismës Socialdemokrate në qendër. Suksese kryetares së Forumit të Gruas së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, znj. Violeta Dema dhe shumë grave e vajzave të reja që po i rrinë besnike vizionit të Nismës në Gjakovë", ka shkruar Fazli Hoxha, kryetar i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë.



Roli dhe rëndësia e ShBA-së në botë

- ShBA-ja, superfuqia e vetme ruajtëse dhe garantuese e paqes dhe rendit botëror



Shkruan: Fehmi RAMA

Primatin e superfuqisë së vetme në botë ShBA-ja e fitoi pas Luftës së Ftohtë. Kjo superfuqi është ruajtëse dhe garantuese e rendit botëror, duke ndaluar gjëra të padëshiruara në shumë shtete. Roli i ShBA-së në vende, qofshin ato të krishtera apo myslimane, ka qenë dhe mbetet crucial për lirinë e qytetarëve anëmbanë botës. Rol të rëndësishëm luajnë ShBA-ja, në jetën e njerëzve duke i mbështetur për lirinë e tyre si dhe ekonominë, por pa u diktuar mënyrën e jetesës. Ishte ShBA-ja që shpëtoi Evropën dhe botën në dy luftërat botërore, po ashtu përmes Planit Marshall u ndihmuan shumë vende në ekonomitë e tyre. Shtetet e Bashkuara ishin prijatë për kundërshtimin e komunizmit dhe në një mënyrë e shpëtuan botën nga një ideologji tejet e dëmshme për njerëzimin.

Shtetet e Bashkuara përmbysen shumë diktatorë shtypës të popujve të ndryshëm, gjithashtu janë në përpjekje të vazhdueshme duke u ndihmuar shtetet e Amerikës së Jugut në luftimin

e substancave narkotike që shpërndahen anëmbanë botës.

ShBA-ja shquhen për mbajtjen e aleatëve dhe stimulimin e krijimit të aleatëve të rinj. Janë flamurtarë të lirisë dhe demokracisë botërore.

Fuqia e shteteve të Bashkuara të Amerikës

ShBA-ja ka sipërfaqe prej 9.83 milionë km² dhe 306 milionë banorë. Ekonomia e tyre është më e madhja në botë, me prodhimin e brendshëm bruto rreth 15 trilionë dollarë, shquhen për burimet e tyre. Buxheti ushtarak i ShBA-së në vitin 2020 ka kapur shifrën 732 miliardë dollarë. ShBA-ja ka gjithashtu avantazh në sajë të gjeografisë. Janë të kufizuara me oqeane, kurse në tokë me shtete që paraqesin rrezik minor në rrafshin e sigurisë.

Forcat e Armatosura të ShBA-së

Shërbimi ushtarak në ShBA është në baza vullnetare,

ndërsa në kohë lufte rekrutimi është i detyrueshëm. Forcat e armatosura me pjesëtarët e Gardës Kombëtare dhe rezervistët arrijnë në 2.3 milionë njerëz të inkorporuar, Departamenti i Mbrojtjes punëson rreth 700 mijë civilë. Forcat amerikane janë të stacionuara në 770 baza të ndryshme jashtë ShBA-së, përveç Antartikut. Viti 2006 bëri që amerikanët të kenë 46 për qind të shpenzimeve ushtarake në botë. Ndonëse nuk është barometër i saktë i matjes së fuqisë ushtarake me koka bërthamore, megjithatë dhe në këtë rrafsh prin ShBA-ja, të pasuar nga Federata Ruse. Ndërsa dallimi nga vendi i parë dhe i dytë me të tjerët është shumëfish më i madh. Me fjalë të tjera, në saje të burimeve që kanë, Shtetet e Bashkuara i bënë superfuqinë e vetme ekonomike dhe ushtarake në botë për të paktën edhe disa dekada.

Shpenzimet ushtarake të shteteve më të fuqishme, prijatë ShBA-së

Viti 2020 e gjeti botën me ngritje të shpenzimeve

ushtarake me 3.6 për qind. ShBA-ja fushës së mbrojtjes ia kushtoi 732 miliardë dollarë, ose 5.3 për qind më shumë se vitin e kaluar. Kina si një vend në zhvillim, për shpenzimet ushtarake ka ndarë 261 miliardë dollarë. India 71.1 miliardë dollarë, kurse Federata Ruse 65.1 miliardë dollarë, ndërsa Arabia Saudite me 61.9 miliardë dollarë dhe Gjermania me 49.3 miliardë dollarë.

Ndikimi botëror i BE-së

Ekonomia dhe fuqia ushtarake e evropianëve mbetet larg ShBA-së, po ashtu këtyre u mungon konsensusi për rol udhëheqës në botë. Me gjithë përafrimin e shteteve evropiane dhe përfaqësimit e tyre në organizata ndërkombëtare, nuk është treguar ndonjë rezultat i madh nga to, në arenën ndërkombëtare. Tendencat për mbikombëtarizim evropian dhe ndikim mbishtetëror në arenën ndërkombëtare janë vështirë të realizueshme.

Tendenca kineze

Kina është gjigante e fjetur, çdoherë ka mbretëruar bindja që ndikimi kinez është kryesisht rajonal. Mirëpo ekonomia kineze në zhvillim, i ka bërë që ata t'i tregojnë muskujt. Republika Popullore e Kinës me të vërtetë është fuqi në rritje, por se i nevojitet ta pesëfishojë fuqinë ushtarake dhe të trefishojë atë ekonomike për t'u barazuar me ShBA-më, shtu këtu që ShBA-ja ka demokraci, kurse Kina është komuniste.

Fuqia e Federatës Ruse

Federata Ruse ka sipërfaqe 17.075 milionë km² dhe popullsi prej 142 milionë banorësh. Federata Ruse është trashëgimtarja e ish-superfuqisë komuniste BRSS. Rusia ka rezerva të mëdha të mineralëve dhe energjisë. Federata Ruse ushtron ndikim botëror në vazhdimësi. Është shteti me sipërfaqen më të madhe në glob, sipas fuqisë blerëse zë vendin e gjashtë në botë. Rusia është anëtare e përhershme e KS të OKB-së dhe është fuqi bërthamore.

Privatizimi në Kosovë, nën hetime

PRISHTINË, 25 TETOR - Procesi i privatizimit në Kosovë, i cili ka nisur 17 vjet më parë, ka përfunduar në një Komision Hetimor Parlamentar, i cili deri më tani ka vënë në pah se ekzistojnë indikacione që ky proces është përcjell me parregullsi të shumta. Komisioni është duke e hetuar procesin e privatizimit i nisur në vitin 2003 nga ish-Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), që u pasua në vitin 2008 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Nga procesi i privatizimit janë shitur mbi 2 000 asete me një vlerë mbi 750 milionë euro. Këto ndërmarrje u privatizuan në mbi 100 valët e privatizimit të zhvilluara deri më tani. Shumica e ndërmarrjeve të shitura në Kosovë janë privatizuar me metodën e quajtur spin-off i rregullt, metodë kjo e cila lejon destinimin e ndërmarrjes, kurse ndërmarrjet që janë konsideruar më të mëdha, janë

privatizuar me metodën spin-off special, që nuk lejon ndërrimin e destinimit të ndërmarrjes.

Nga privatizimi nuk shpëtuan as sipërfaqet e tokave bujqësore në pronë publike. Agjencia Kosovare e Privatizimit, përmes valëve të privatizimit, në vazhdimësi ka shpallur në shitje sipërfaqe të ndryshme të tokës bujqësore.

Në një raport të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të publikuar në muajin nëntor të vitit të kaluar, thuhet se janë privatizuar 663 toka bujqësore dhe toka të kategorive të tjera, pa specifikuar sipërfaqen. Nga ky numër thuhet se 595 janë tokë bujqësore, kurse 68 toka të kategorive të tjera. E gjithë kjo sipërfaqe, sipas raportit të AKP-së, është shitur për rreth 164 milionë euro.

Për privatizimin e këtyre aseteve, komisioni parlamentar hetimor ka ftuar 21 dëshmitarë, përgjegjës të procesit të privatizimit.



Të ftuar janë ish-ministra përgjegjës për privatizimin, kryesues dhe anëtarë të bordit dhe ish-kryesues dhe anëtarë të bordit të AKP-së dhe AKM-së, drejtorë menaxhues dhe ish-drejtorë menaxhues të AKP-së dhe AKM-së dhe ish-zyrtarë të UNMIK-ut të shtyllës së katërt, që në atë kohë e kishin mbuluar privatizimin.

Intervistimi i dëshmitarëve ka filluar më 12 tetor, pas sigurimit të një dokumentacioni nga institucionet relevante si Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe institucione të tjera. Për shqyrtimin e këtij dokumentacioni janë angazhuar edhe ekspertët e jashtëm. Gjashtë nga 21 dëshmitarët e

thirrur nga ky komision janë dëgjuar deri më tani, ndërsa me pjesën e mbetur do të vazhdohet në dy javët e ardhshme. Këta 21 dëshmitarë janë vetëm grupi i parë pasi që, siç thotë Hajrullah Çeku, kryetar i komisionit shumë shpejt do të jetë edhe grupi i dytë i dëshmitarëve që do të ftohen nga komisioni.

Në grupin e dytë të intervistuarve do të jenë të ftuar pronarë të kompanive që kanë privatizuar ndërmarrje shoqërore, ekspertë dhe njohës të çështjes së privatizimit, gazetarë dhe aktivistë që kanë përcjell procesin e privatizimit dhe ish-punëtorë të ndërmarrjeve që kanë raste dhe konteste lidhur me të drejtat e tyre.

Komisioni ende nuk ka dhënë konstatime përfundimtare lidhur me atë se çfarë shkeljesh të procedurave apo keqpërdorime eventuale mund të kenë ndodhur në procesin e privatizimit. (Rel)

Italia nga java e ardhshme shtrëngon masat pas rritjes së rasteve të reja



ROMË, 25 TETOR - Italia ka marrë vendim t'i mbyllë kinematë, pishinat dhe palestrat nga e hëna, në një përpjekje të radhës për ta frenuar rritjen e shpejtë të infeksioneve të koronavirusit. Baret dhe restorantet do të duhet të mbyllën deri në orën 18:00, por dyqanet dhe shumica e bizneseve do të vazhdojnë të funksionojnë. Ndërkohë kabineti qeveritar i Spanjës të dielën ra dakord për

një "gjendje alarmi" në të gjithë vendin. Të dyja vendet u goditën rëndë gjatë valës së parë të pandemisë në Evropë. Shtrëngimi i masave u miratua midis kryeministrit Giuseppe Conte dhe udhëheqësve rajonalë. Rajoni i Campania, ku përfshihet Napoli, ka qenë ndër ata që kërkojnë kufizime më të rrepta. Conte ka thënë se ai nuk dëshiron ta përsërisë bllokimin kombëtar të vendosur gjatë

valës së parë në mars dhe prill për shkak të dëmit ekonomik të shkaktuar. Sipas masave të reja, pjesa më e madhe e mësimit në shkollat e mesme do të zhvillohet online. Shtrëngimi i masave vjen në kohën e protestave në Napoli dhe, më pas në Romë, kundër ashpërsimit të tyre. E shtuna shënoi një rekord të ri rastesh në Itali me më shumë se 19 600 të infektuar. Numri i vdekjeve në 24 orë ka shkuar në 151.

Pompeo dhe Lukashenka diskutojnë në telefon, presioni opozitar vazhdon të rritet

WASHINGTON, 25 TETOR - Sekretari i Shtetit në Shtetet e Bashkuara, Mike Pompeo, mbajti një telefonatë me liderin e Bjellorusisë Alyksandr Lukashenka, derisa presioni po rritet mbi udhëheqësin autoritar përpara një ultimatumit të opozitës për t'i dhënë fund mandatit të tij ose do të përballet me protesta dhe greva në mbarë vendin. Departamenti i Shtetit i tha "Radios Evropa e Lirë" më 24 tetor se Pompeo kërkoi lirim të

një strategu politik bjellorus-amerikan, ndalimin e të cilit Qeveria e ShBA-së e ka quajtur "të padrejtë". "Sekretari bëri thirrje për lirim të plotë dhe largimin e menjëhershëm nga Bjellorusia të shtetasit amerikan të ndaluar padrejtësisht, Vitali Shklyarov dhe rikonfirmoi mbështetjen e ShBA-së për aspiratat demokratike të popullit të Bjellorusisë", tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit. Shklyarov, i cili punoi në fushatat e ish-presidentit

Barack Obama dhe Senatorit Bernie Sanders, u arrestua në fund të korrikut ndërsa ishte duke vizituar familjen e tij në Bjellorusi. Ai u lirua me kusht në pritje të gjyqit për ato që konsiderohen gjerësisht si akuzat politike të trilluara. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë refuzuar t'i pranojnë rezultatet e zgjedhjeve ku Lukashenka sërish është udhëheqës i ligjshëm i ish-Republikës Sovjetike.



Forcat afgane vrasin një lider të Al-Kaidës



KABUL, 25 TETOR - Forcat afgane të sigurisë kanë vrarë Abu Muhsin al-Masri, një udhëheqës i lartë i Al-Kaidës, i cili gjithashtu kërkohej nga Shtetet e Bashkuara. Drejtoria Kombëtare e Sigurisë e Afganistanit tha më 24 tetor se Al-Masri, që besohet të jetë figura e dytë kryesore në Al-Kaidë, u vra nga forcat speciale në provincën qendrore Ghazni. Ai nuk dha më shumë detaje dhe nuk tha kur ai u vra. Al-Masri, një shtetas egjiptian i cili gjithashtu quhej me emrin

Husam Abd-al-Ra'uf, ishte udhëheqës i lartë i Al-Kaidës dhe drejtoi operacionet mediatike të veshjeve terroriste. Ai ishte në listën e terroristëve më të kërkuar të FBI-së për ofrimin e mbështetjes për një organizatë terroriste dhe konspiracionin për t'i vrarë qytetarët e ShBA-së. Vrasja e Al-Masrit vjen derisa talibanët dhe qeveria afgane vazhdojnë bisedimet e paqes në Katar që synojnë t'i japin fund gati 19 vjetëve të luftës. Pavarësisht prej bisedimeve të

paqes, militantët dhe Kabuli përfshihen në luftime pothuajse të përditshme. Negociatat pasojnë një marrëveshje midis Shteteve të Bashkuara dhe talibanëve të nënshkruar në shkurt, e cila parashikon që forcat e ShBA-së të largohen nga Afganistani dhe talibanët të angazhohen për të mos lejuar që toka afgane të përdoret nga grupet terroriste për të filluar sulme jashtë vendit. Mbeten pyetje nëse talibanët mund ose do të kenë lidhje të ashpra me Al-Kaidën.


ShBA-ja shënon rritjen më të madhe të të infektuarve që nga vera

WASHINGTON, 25 TETOR - Pandemia e koronavirusit po vazhdon përhapjen në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, duke shënuar rritje të madhe të rasteve të reja dhe vdekjeve. Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi këtë javë për një rritje të infeksioneve që kërcënon sistemet shëndetësore të shteteve. Mesatarja e infeksioneve të reja në Shtetet e Bashkuara ka shkuar në gati 70 000, duke tejkaluar këtë fundjavë kulmin e rasteve që ishin në korrik. Numri i vdekjeve pritet të

rritet deri në 700 në ditë. ShBA-ja është vendi më i prekur në botë nga koronavirusi, me mbi 8.2 milionë njerëz të infektuar. Në Evropë, një valë e dytë e virusit po zhvillohet. Vendet po përpunohen ta kontrollojnë përhapjen përmes një sërë masash të reja, duke shpresuar të shmangin një lloj bllokimi të ekonomisë së shkatërruar nga pranvera. Spanja, ku autoritetet thonë se infeksionet totale kanë të ngjarë ta trefishojnë shifrën zyrtare prej një milioni, duket se po shkon drejt vendosjes së një 'gjendje alarmi'.



Picasso: Arti është një gënjeshtër që na ndihmon të realizojmë të vërtetën



E kam të vështirë ta kuptoj rëndësinë që i jepet fjalës “kërkim” në lidhje me pikturën moderne. Simbas meje, në pikturë, kërkim nuk do të thotë asgjë. Të gjesh: ky është problemi. Askujt nuk mund t’i zgjojë kureshtje një njeri që vështron ngultazi përtokë, duke kërkuar kuletën që rastësia mund ta ketë hedhur në rrugë. Kush gjen diçka, nuk ka rëndësi se çfarë, edhe nëse kërkimi i asaj gjëje s’ ishte qëllimi i tij, ai po që na zgjon kureshtjen, pse jo dhe admirimin.

Pablo PICASSO

Më kanë akuzuar se kam kryer shumë mëkate: por akuzat më e rreme është se unë paskam si qëllim kryesor të punës sime prirjen për të kërkuar. Kur pikturoj, qëllimi im është të tregoj atë që kam gjetur dhe jo atë që po kërkohet. Në art qëllimet nuk janë të mjaftueshme dhe, siç themi ne në Spanjë, dashuria duhet të tregohet me vepra dhe jo me argumente. Vlerë ka ajo që bëjmë dhe jo ajo që synojmë të bëjmë.

Të gjithë e dimë se arti nuk është e vërteta. Arti është një gënjeshtër që na ndihmon të realizojmë të vërtetën, së paku të vërtetën që na është dhënë të kuptojmë. Artisti duhet të dijë mënyrën me të cilën do t’i bindë të tjerët për të vërtetën e gënjeshtërave të tij. Nëse nëpërmjet punës së tij ai arrin të na tregojë vetëm faktin se ka kërkuar dhe rikërkuar mënyrën e realizimit të gënjeshtërave të tij, ai kurrë nuk do mund të arrijë diçka.

Shpeshherë ideja e kërkimit e ka nxjerrë pikturën nga udha, ndërsa artistin e ka bjerrë nëpër stërholime mendore. Ndoshta ky ka qenë gabimi kryesor i artit modern. Shpirti i kërkimit i ka helmuar ata që nuk i kanë kuptuar plotësisht të gjithë elementët pozitivë dhe përmbyllës të artit modern dhe i ka bërë të përpiqeshin të

pikturonin të padukshmen, pra të papikturueshmen.

Ata flasin për natyralizëm dhe kundërvënien ndaj pikturës modene. Do më pëlqente të njihja ndokënd që ka parë një vepër arti natyrale. Natyra dhe arti, duke qenë dy realitetet krejtësisht të ndryshme, nuk mund të jenë e njëjta gjë. Nëpërmjet artit ne shprehim konceptimin e asaj që natyra nuk është.

Velázquez na ka përcjellë shëmbëlltyrën e njerëzve të epokës së tij: pa dyshim që ata ishin ndryshe nga ç’i ka pikturuar ai, por ne nuk mund të konceptojmë Filipin IV ndryshe nga ç’e ka pikturuar Velázquez. Edhe Rubens ka bërë një portret të të njejtës mbret, por duket tjetër njeri. Ne besojmë në atë që ka pikturuar Velázquez sepse ai na bind me të drejtën e pushtetit. Qysh nga origjina, nga primitivët, veprat e të cilëve janë qartësisht të ndryshme nga natyra, dhe deri tek artistë si David, Ingres, e deri dhe Bouguereau, të cilët besonin se e pikturonin natyrën ashtu siç është, arti ka qenë përherë art dhe jo natyrë. Dhe nga pikëpamja e artit nuk ka forma konkrete apo abstrakte, por vetëm forma, të cilat s’janë gjë tjetër veçse gënjeshtër bindëse. Nuk ka dyshim se këto gënjeshtër janë të nevojshme për pjesën tonë mendore, sepse pikërisht përmes tyre ne mund të krijojmë këndvështrimin tonë

estetik mbi jetën.

Kubizmi nuk është i ndryshëm nga asnjë shkollë tjetër e pikturës. Për të gjitha shkollat janë të përbashkëta të njejtët parime e të njejtët elementë. Fakti se për shumë vite kubizmi nuk është kuptuar, dhe ka ende sot ka njerëz të cilët nuk arrijnë ta shohin, nuk do të thotë kurrëgjë. Unë nuk di të lexoj në anglisht. Një libër në anglisht për mua është një libër i bardhë. Por ama kjo s’do të thotë se gjuha angleze nuk ekziston. Përse duhet të qortoj ndokënd, veç vetvetes, nëse nuk arrij të kuptoj diçka rreth së cilës nuk di kurrëgjë?

Shpesh dëgjoj të shqiptohet fjala evolucion. Më kërkohet të shpjegoj se si evoluon piktura ime. Për mua, në art nuk ka të shkuar apo të ardhme. Nëse një vepër arti nuk mund të jetojë përgjersa në të tashme, nuk duhet të merret në konsideratë. Arti i grekëve, i egiptianëve, i piktorëve të mëdhenj që jetuan në kohë të tjera, nuk është art i së shkuarës. Mbase sot është më i gjallë nga ç’ka qenë ndonjëherë. Arti nuk evoluon vetvetiu, idetë e popujve ndryshojnë e bashkë me to ndryshojnë edhe mënyrat e shprehjes. Kur dëgjoj të flitet për evoluimin e ndonjë artisti, më duket sikur njerëzit e shikojnë atë në këmbë midis dy pasqyrave që riprodhojnë shëmbëlltyrën e tij në sasi të panumërt- e që kundrojnë edhe shëmbëlltyrat vijuese të pasqyrës tjetër si të

ardhmen e tij- teksa shëmbëlltyra e tij e vërtetë ndodhet në të tashme.

Ndryshimi nuk do të thotë evolucion. Nëse një artist ndryshon ekspresionin e tij, kjo do të thotë se ai ka ndryshuar vetëm mënyrën e tij të menduarit, gjë që mund të jetë për më mirë ose për më keq. Mënyrat e shumta që kam përdorur unë nuk duhet të konsiderohen si një evolucion apo si shkallë që çojnë drejt një ideali të panjohur të pikturës. Gjithë ç’kam bërë ka qenë gjithnjë për të tashmen, me shpresën e të mbeturit përherë në të tashmen.

Kur kam gjetur diçka për të shprehur, e kam bërë pa menduar për të shkuarën apo të ardhmen. Nuk besoj se në mënyrat e mija të ndryshme kam përdorur elementë rrënjësisht të ndryshëm; nëse objektet që kam dashur të shpreh më kanë propozuar mënyra të ndryshme ekspresioni, unë nuk kam ngurruar fare t’i përdor. Unë nuk kam bërë as eksperimente e as prova. Kur kam diçka për të thënë, e them në mënyrën që më duket më natyrale. Motive të ndryshme kërkohet në mënyrë të pashmangshme metoda të ndryshme ekspresioni. Kjo nuk do të thotë evoluim apo ecje përpara, por përshtatje e idesë që duam të shprehim me mënyrat e shprehjes së kësaj ideje.

Arti kalimtar nuk ekziston. Në historinë kronologjike të artit ka

periudha që janë më pozitive dhe më të plota se të tjerat; kjo do të thotë vetëm se ka periudha në të cilat ekzistojnë artistë më të mirë se në periudhat e tjera. Nëse historia e artit do mund të paraqitej në mënyrë grafike, ashtu siç veprohet me digramat që shënojnë ndryshimet e temperaturës së të sëmurit, do viheshin re të njejtat linja që ulen e çohen, duke provuar kështu që në art nuk ka ngjitje dhe përparim, por shënohen do lloj uljesh e ngritjesh si në çdo tjetër fushë. E njejtat gjë ndodh edhe në punën individuale të një artisti.

Shumë njerëz mendojnë se kubizmi është një art kalimtar, një eksperiment që nuk mund të sjellë rezultate të mëtejshme. Ata që mendojnë kështu nuk e kanë kuptuar. Kubizmi nuk është një farë apo fetus, por art që trajton një shkallë formash parësore, dhe kur një formë realizohet shfaqet aty për të jetuar jetën e saj. Një lëndë minerale që ka një formë geometrike nuk është bërë për qëllime kalimtare; ajo është aty për të mbetur dhe mbetur përherë në formën e saj; nëse duam të zbatojmë në art ligjet e evolucionit dhe të transformizmit, atëherë duhet të pranojmë që gjithçka është kalimtare. Por, në të kundërt, arti nuk hyn në këto absolutizma filozofike. Në qoftë se kubizmi ishte art kalimtar, unë jam i bindur se e vetmja formë që do mund ta pasonte kishte për të qenë një formë tjetër e kubizmit. Janë bërë përpjekje për ta shpjeguar kubizmin nëpërmjet matematikës, trigonometrisë, kimisë, psikanalizës, muzikës, e kushedi ç’gjëje tjetër. E tërë kjo s’ka prodhuar send tjetër përpos letërsi, për të mos thënë “pa kuptim”, dhe ka sjellë rezultatin e keq të verbimit të njerëzve përmes teorive.

Kubizmi ka qëndruar përherë brënda kufinjve të pikturës, duke mos mëtuar kurrë të dalë jashtë saj. Vizatimi, piktura dhe ngjyra janë mirëkuptuar dhe përkushtuar në kubizëm po me të njejtin shpirt dhe mënyrë siç janë mirëkuptuar në shkollat tjera. Kohërat tona mund të jenë të ndryshme sepse ne kemi ndërkallur në pikturë objekte dhe forma të panjohura më parë, kemi hapur sytë mbi gjithë çfarë na qarkon, e edhe mendjen.

Formës dhe ngjyrës u kemi dhënë kuptimin e tyre të veçantë gjer ku kemi arritur ta shohim. Në objektet tanë ruajmë harenë e zbulimit, kënaqësinë e së papriturës; vetë objekti ynë duhet të jetë një burim vëmendjeje. Por ç’dobi ka vallë të flasim rreth asaj që bëjmë, në një kohë kur të gjithë mund ta shikojnë, nëse duam?

Përktheu: Shpëtim Kelmendi / KultPlus/

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Trepça '89 arrin fitore të 'çmendur' ndaj Ballkanit, Gjilani mposhti Prishtinën



Trepça '89 ka bërë një rikthim sensacional në përballje me Ballkanin, pasi nga rezultati 0-3 arriti përmbysjen dhe në fund mori tri pikët e plota (4-3). Fitore të rëndësishme shënoi edhe Gjilani në kryeqytet në përballje me Prishtinën, kurse të shtunën fitoren e parë në këtë kampionat e ka shijuar Llapi. Tri pikë të plota mori edhe Drita, kurse Feronikeli e ka regjistruar edhe një barazim

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 25 TETOR - Dy ndeshjet e fundit të javës së tetë të Superligës së Kosovës në futboll janë zhvilluar të dielën. Fitore të 'çmendur' ka regjistruar skuadra e Trepçës '89 kundër Ballkanit, pasi ka arritur të shënojë fitore në ndeshjen që po e humbiste me rezultat 0-3. Ndeshja e zhvilluar në Mitrovicë përfundoi 4-3. Në minutën e 31-të Nazmi Gripshi e kaloi skuadrën mysafire në epërsi (0-1). Në fillim të pjesës së dytë Ermal Krasniqi realizoi për 0-2, kurse sulmuesi më i mirë aktualisht në Superligë, Mirlind Daku, shënoi për 0-3. Pavarësisht prej këtij rezultati, vendasit nuk u dorëzuan dhe shënuan golin e parë nëpërmjet Bismarek në minutën e 65-të. Dhjetë minuta me vonë Rrahim Nimani shënoi për 2-3, kurse Bismarku e barazoi rezultatit në 3-3. Pavarësisht prej barazimit, vendasit nuk u dorëzuan dhe arritën ta shënojnë edhe golin e katërt që i solli tri pikë. Golashënues në minutat shtesë ishte Bismarku i cili e komplettoi tregolëshin.

Pas kësaj ndeshje, Trepça '89 ka grumbulluar njëmbëdhjetë pikë dhe renditet e gjashta në renditjen tabelore, kurse Ballkani vazhdon të jetë në pozitën e parë me 19 pikë. Ndërsa në ndeshjen tjetër, Gjilani ka marrë tri pikë nga përballja me Prishtinën në stadiumin "Fadil Vokrri", pasi ka shënuar fitore me rezultat 0-2. Skuadra

mysafire kaloi në epërsi pas trembëdhjetë minutave lojë, kur penalltinë e fituar nga Kçiku e konvertoi në gol Fiton Hajdari. Prishtina u mundua ta barazojë rezultatit në pjesën e parë por, pa sukses. Pjesa e dytë ishte më e mirë për vendasit që sulmuan pareshur në drejtim të gjilanasve. Fustar e largon për mrekulli harkimin e Krasniqit, më pas Bekteshi ishte afër që ta befasojë portierin Koliçi. Ky i fundit në minutën e 58-të ndali gjuajtjen e Endrit Krasniqit. Portieri Koliçi edhe një herë ishte vendimtar për Gjilani, pasi ndali penalltinë e Krasniqit. Mankenda gjuajti jashtë, kurse gjuajtjen e Shillovës e ndali portieri mysafir. Kur të gjithë pritën barazimin e Prishtinës, në skenë doli Progni në minutat shtesë dhe realizoi për 0-2. Pas kësaj ndeshje, Prishtina bie në pozitën e katërt me 11 pikë, kurse Gjilani merr pozitën e tretë me 13 pikë të grumbulluara. Të shtunën Drita ka shënuar fitore bindëse ndaj Drenicës (4-1). Bujar Shabani, Hamdi Namani, Kastriot Rexha dhe Betim Haxhimusa shënuan golat për Dritën, kurse për ekipin mysafir golin e vetëm e shënoi Zabërgja. Fitores së parë në këtë kampionat iu gëzua Llapi që e mposhti në stadiumin "Zahir Pajaziti" Arbërinë (2-0). Për skuadrën e Tahir Batatinës shënuan Mentor Zhdrella dhe Ahmed Januzi, kurse në ndeshjen tjetër Besa e Feronikeli barazuan me rezultat prej 1-1. Brruti shënoi për Besën, kurse për "Nikli" golin e vetëm e shënoi Miliçkovic.

SHKURT

Vashat e Bashkimit fitojnë Superkupën

KBF Bashkimi e ka fituar Reload Superkupën e Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave, duke mundur në finale Kosovahome Prishtinën me rezultat 75:72 (30:22, 19:10, 14:16, 12:24). Te Bashkimi u dalluan Arbnore Përçuku me 21 pikë, 10 kërcime e 7 asistime dhe Lejzae Davidson me 16 pikë e 11 kërcime, kurse te skuadra prishtinase më të dalluarat ishin Enxhi Khanaj me 24 pikë e 12 kërcime dhe Era Shatri me 15 pikë e 20 kërcime. Kupën kapitenes së Bashkimit, Gresa Gashi ia dorëzoi sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku.

Rama jep dorëheqje nga posti i trajnerit në KF Drenica

Fadil Rama ka dhënë dorëheqje nga posti i trajnerit të skuadrës së KF Drenica. Njoftimin e ka dhënë faqja zyrtare e skuadrës kuqezit në "Facebook". "Kryetrajneri i deritanishëm i skuadrës, Fadil Rama, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e të parit në stolin e KF Drenicës, pas humbjes 4-1 kundër FC Drita", thuhet në njoftimin e KF Drenicës.

KH Besa regjistron fitoren e katërt

KH Besa Famgas e ka fituar thellë ndeshjen e xhiros së katërt të Superligës së Kosovës në hënoll (meshkujt). Kampionia në fuqi në Podujevë fitoi ndaj Llapit me rezultat 38:13. Për Besën ishte fitorja e katërt, kurse për Llapin humbja e katërt. Fitore shënoi edhe Kastrioti që në Ferizaj e mposhti Vëllaznimin me rezultat 35:27. Ferizajasit shënuan fitoren e dytë, kurse Vëllaznimi pësoi humbjen e tretë. Ndeshje e barabartë u luajt në Drenas, ku u takuan Drenica e Trepça. Madje ndeshja nuk dha fitues fare, përfundoi 25:25. Edhe pas pjesës së parë rezultati ishte i barabartë, 14:14. Është ky barazimi i parë në këtë edicion. Drenica renditet e treta me 5 pikë, sa i ka edhe Trepça në vend të katërt. Në pjesën e parë mysafirët ishin në epërsi të lehtë, por vendasit ia dolën të barazojnë në fund. Edhe në pjesën e dytë vazhdoi loja e barabartë. Drenica në fund dy herë kishte nga dy gola epërsi, por mitrovicasit me përvojë ia dolën të barazojnë në 25:25.

Bogdani: Shabani Nonda blloko transferimin tim në Romë

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë dhe shumë skuadrave në Itali, Erjon Bogdani, ka bërë me dije se në vitin 2007 ishte shumë afër kalimit te Roma. Bogdani ka thënë se dështimi i kalimit të Shabani Nonda te Galatasray e blloko transferimit e tij në Romë. "Kam qenë shumë pranë Romës në vitin 2007. Drejtori Sartori më pati thënë se mund të shkoja aty dhe ishte një gëzim i madh për mua, por në fund transferimi nuk u realizua. Prisja që Shabani Nonda të ikte dhe unë ta zija vendin e tij. Ai nuk u transferua dot te Galatasray dhe gjithçka u prish 30 minuta para mbylljes së merkatos. E konsideroj Romën një skuadër të madhe, sepse në ato vite luftonte për titull", ka thënë Bogdani.

SUPERLIGA

Trepça '89 - Ballkani	4-3
Prishtina - Gjilani	0-2
Drita - Drenica	4-1
Llapi - Arbëria	2-0
Besa - Feronikeli	1-1

Tabela

		PIKË
1. Ballkani	8	19
2. Drita	6	13
3. Gjilani	8	13
4. Prishtina	7	11
5. Arbëria	8	11
6. Trepça '89	8	8
7. Drenica	8	8
8. Feronikeli	8	7
9. Llapi	7	5
10. Besa	8	5

Në xhiron e radhës takohen: Arbëria-Drita, Feronikeli-Llapi, Drenica-Trepça '89, Gjilani-Besa, Ballkani-Prishtina.

LIGA E PARË

Grupi A

Trepça - Istogu	1-1
Onix Banja - Vushtrria	2-1
Dukagjini - A&N	1-0
Drenasi - Liria	0-2
Malisheva - Vëllaznimi	1-0

Grupi B

Ferizaj - Flamurtari	1-1
Vitja - Ramiz Sadiku	1-0
KEK-u - Vllaznia	0-0
2 Korriku - Kika	2-0

Të hënën takohen:
14:00 Ulpiana - Dardana

Napoli 'blindon' Gattuson

NAPOLI, 25 TETOR - Drejtuesit e Napolit janë shumë të kënaqur me punën që po bën trajneri Gennaro Gattuso dhe janë gati t'i rinovojnë kontratën, pasi ajo aktualja përfundon në qershor të vitit 2021.

Drejtori Sportiv Giuntoli ka

zbuluar se negociatat kanë shkuar mirë dhe se vullneti i palëve është që të vijojnë së bashku, por pa dhënë një datë se kur do të firmoset kontrata e re. "Nuk kemi problem me Gattuson, pasi ai dëshiron të qëndrojë dhe ne jemi shumë të kënaqur me punën që po

bën. Kur të gjitha palët kanë vullnetin maksimal për të vazhduar së bashku, edhe negociatat janë më të lehta", u shpreh Giuntoli.

Është raportuar se tashmë është arritur marrëveshja për zgjatjen e bashkëpunimit mes Napolit e Gattusos deri në

verën e 2023-shit, me klubin e De Laurentiis që ka ruajtur edhe opsionin e rinovimit për një vit më tepër. Gattuso do të përfitojë një pagë prej 1.9 milionë eurosh në sezon, plus bonuset në lidhje me ecurinë, të cilat mund ta çojnë në minimalisht 2.5 milionë euro.



Khabib pensionohet si kampion

MAKHACHKALA, 25 TETOR - Khabib Nurmagomedov e mbyll triumfin si kampion absolut në UFC. Rusi fitoi në raundin e dytë kundër Justin Gaethje. Raundi i parë u fitua nga luftëtari nga Dagistani me rezultatin 10-9, ndërsa në fillimin e së dytës do të mbyllej gjithçka. Khabib arriti të mbërthente mjaft mirë Gaethjen dhe ky i fundit u dorëzua. Khabib tashmë ka një rekord prej 29 fitoresh dhe asnjë humbje duke mbetur kampion i pamposhtur, ndërkohë që deklaroi se e ka mbyllur këtu në UFC, pasi nuk do të luftojë më. Ai u përlot pas fitores pasi ka humbur të atin. 32-vjeçari ka thënë se nuk do të luftojë më për nder të babait të vet të ndjerë, Abdulmanap, i cili ishte edhe mentori dhe trajneri i tij, që vdiq në korrik pas problemeve shëndetësore që ia shkaktoi Covid-19. "Kjo ishte lufta ime e fundit. Në asnjë mënyrë nuk do të kthehet këtu pa babanë tim", ka deklaruar Khabib. Pak orë pas meçit,



Khabibi shkroi në "Instagram", duke ia uruar babait të vet parajsën. "Kur je me Allahun, askush, ama askush nuk mund të të thyejë. Faleminderit për

gjithçka që më ke mësuar gjithë jetën, baba! Allahu të shpërbleftë me gradën më të lartë të xhenetit!", ka shkruar Khabib.

Lewandowski thyen rekordin e legjendës Muller

MUNCHEN, 25 TETOR - Iu privua e drejta për ta fituar për herë të parë në karrierë "Topin e Artë", por Robert Lewandowski nuk po dorëzohet. Nuk arriti as ta fitojë "Këpucën e Artë", por as në këtë pikë nuk është dorëzuar, vijon me të njëjtin intensitet edhe këtë sezon në kërkim të dy trofeve që i shpëtuan nga duart, pjesa tjetër është e gjitha një histori e bukur për t'u rrëfyer teksa me Bayernin fitoi gjithçka që ishte në lojë, pesë trofe. Lewandowski dhe Bayerni kanë nisur këtë sezon gjithçka nga e para, sërish me të njëjtën uri teksa ndodhen një pikë larg kreut në Bundesligë, ndërsa në Ligën e Kampionëve e çmontuan Atletico Madridin me një "poker" golash. Ndaj Eintracht Frankfurt, polaku



shpërtheu me një "tripletë" duke e dërguar në dhjetë numrin e golave të shënuar në pesë javë kampionat. Ky është një rekord absolut në Bundesligë duke kaluar edhe

një legjendë si Gerd Mulleri. Shifra e sulmuesit polak vijon ta magjepsë botën e futbollit. Aktualisht është ai qendërsulmuesi më i mirë në qarkullim.

Nuk dihet data e rikthimit të Coutinhos

Philippe Coutinho është lënduar në "El Clasico". Braziliiani u aktivizua 90 minuta kundër Real Madridit, kurse

klubi katalanas bën me dije se Coutinho ka një problem muskolor. "Coutinho ka një dëmtim në 'biceps femoris' në

kofshën e majtë të tij. Koha e rikthimit në fushë do të varet nga evoluimi i rikuperimit", thuhet, mes të tjerash, në

njoftimin e Barcelonës. Coutinho u kthye këtë verë te Barcelona, pasi ishte huazuar te Bayern Munchen. Ai është

paraqitur në pesë ndeshje të kampionatit dhe në një sfidë në Ligën e Kampionëve, duke shënuar edhe dy gola.

SHKURT

Prishtina regjistron fitoren e tretë, Kastrioti të dytën

Skuadra e Prishtinës e ka shënuar fitoren e tretë rresht në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Prishtina në Deçan fitoi ndaj skuadrës Jusuf Gërvalla me rezultat 33:20. Kryeqytetaset prijnë në tabelë me 6 pikë, kurse Jusuf Gërvalla renditet e gjashta me dy pikë. Të shtunën u luajt edhe një ndeshje tjetër e javës së tretë. Në Ferizaj, Kastrioti fitoi ndaj Vjosës me rezultat 41:20. Kastrioti ka dy fitore e një humbje dhe renditet i treti me katër pikë. Vjosa është në pritje të pikëve të para.

Koeman: VAR-i po përdoret vetëm ndaj Barçës

Mjaft i zhgënjyer u shfaq trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman. Ai vlerësoi maksimalisht paraqitjen e lojtarëve të tij, por akuzoi se VAR-i u përdor vetëm kundër katalanëve. "Në nivelin e lojës jam i kënaqur, pasi zhvilluam një ndeshje të mirë. Në minutat e fundit rrezikova më shumë se duhet, por ishim në humbje dhe nuk bënte ndryshim nëse ndeshja do të mbaronte 1-2 apo 1-3. Megjithatë, jam shumë i zhgënjyer me përdorimin e VAR-it. Për mua penalltia për Realin nuk ishte dhe aty u vendos fati i ndeshjes. Për më tepër, dua që gjyqtarët të më sqarojnë si funksionon ky sistem, pasi po shoh që përdoret vetëm për episode kundër Barcelonës", ka thënë Koeman.

Zidane: Fitorja ndaj Barçës vlen vetëm tri pikë

Trajneri Zinedine Zidane është shfaqur mjaft i kënaqur për fitoren ndaj Barcelonës, por theksoi se janë vetëm tri pikë dhe se skuadra duhet të shohë përpara, duke nisur nga ndeshja e të martës në Ligën e Kampionëve. "Nuk është e lehtë të vish dhe të fitosh në 'Camp Nou', ndaj jam shumë i lumtur për këtë sukses. Ishte një fitore grupi, por vlen vetëm tre pikë, tash duhet të nisim të mendojmë për ndeshjen e të martës në Ligën e Kampionëve. Barcelona luan shumë hapur dhe kjo na lehtësoi gjetjen e hapësirave, ndryshe nga ndeshjet kundër skuadrave që mbyllën në gjysmëfushën e tyre", ka thënë Zidane.

Lëndohet Alphonso Davies, mungon rreth 8 javë

Lajme aspak të mira për Bayern Munchenin dhe trajnerin Hansi Flick. Mbrojtësi i krahut, Alphonso Davies, ka pësuar një lëndim në ligament dhe duhet të ndalet në një moment të mirë për të. "Ai ka një dëmtim në ligament dhe do të mungojë 6-8 javë", ka thënë Flick.

Milani planifikon transferimin e Draxlerit

Futbollisti gjerman i Paris Saint Germain, Julian Draxler, është synim i skuadrës së Milanit. Draxler ka kontratë deri në qershor të vitit të ardhshëm me PSG-në, por mund të largohet për faktin se klubi aktual nuk e ka ndërmend t'i rinovojnë kontratën. 28-vjeçari përfiton rreth 4 milionë euro neto në sezon te Paris Saint Germain dhe te Milani janë gati t'i ofrojnë të njëjtën shumë, për një kontratë 5-vjeçare, si dhe një bonus në momentin e firmës.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER)
Procurement Ref. Number	RFQ / 2020/No. 015
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	23 October 2020
Submission Deadline	09 November 2020; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the "Threshold Program agreement", and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER).

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites *password protected bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements under IDIQ Contract relate to two specific tasks to be performed by the Contractor. One task is related to the site visit, detail measurements of building and preparation of sub-project Bill of Quantities (Service Order) and another task relates to the energy efficiency works to be provided on the specific household (Works Order).

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement>

A pre-Bid conference shall take place at the 29 October 2020, at 14:00 am (Kosovo Time), through Zoom meeting link: <https://us02web.zoom.us/j/85692269759>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than 09 November 2020 at 14:00 (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address(es) referred to above is (are):	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	https://millenniumkosovo.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kosovar Leskovci shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Emin Duraku" Prishtinë.

► Marcel Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jasir Avdyli shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Silver Shaipi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Drita Muçaj shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Mitat Rakaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: -VII- të shkollës fillore "Lekë Dukagjini", Prizren.

► Miranda Dedaqi shpall të pavlefshme dëftesat e diplomën dhe certifikatën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 35 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, ri-shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta të Radiotelevizionit të Kosovës

Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta:

- Duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta emërohet nga Bordi i Drejtorëve, në bazë të rekomandimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Planifikon, organizon, monitoron dhe udhëheqë procesin e punës së Shërbimeve të Përbashkëta;
- Implementon Politikën e RTK-së të përcaktuara me ligj, Statut dhe nga ana e Bordit të Drejtorëve të RTK-së;
- Merr pjesë aktive në implementimin e strategjisë zhvillimore të RTK-së dhe mbikëqyrë realizimin e planeve afatgjata dhe afatshkurtra;
- Përgatitë Raportin vjetor të Shërbimeve të Përbashkëta, në kuadër të planit afarist duke përfshirë edhe përmbushjen e planit të resurseve njerëzore me arsyetim;
- Ofron informata të rregullta Drejtorit të Përgjithshëm rreth gjendjes financiare, posaçërisht për tejkalimin e shpenzimeve në linjat e posaçme buxhetore dhe rënien eventuale në të hyra;
- Kontrollon zbatimin e planit financiar të RTK-së, posaçërisht në fushën e investimeve të reja;
- Është përgjegjës për strategjinë financiare dhe zbatimin e saj;
- Bënë parafimin e kontratave nga fusha e investimeve të reja;
- Nënshkruan dokumentet e ndërlidhura me punën dhe afarizmin e sektorëve;
- Mbikëqyrë zbatimin e sistemit kompjuterik për lëmin e financave;
- Mbikëqyrë dhe koordinon punët e zyrës ligjore dhe politikën rregullative të RTK-së dhe kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve, kontratave dhe akteve tjera;
- Përgatitë planin vjetor financiar, i cili është pjesë përbërëse e planit afarist programor të RTK-së;
- Së bashku me anëtarët tjerë të Menaxhmentit, përgatitë planet për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit;
- Mbanë takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Mbikëqyrë zhvillimin e kuadrit të RTK-së me perspektivë (karrierë – “resurset njerëzore”);
- Përgatitë dhe nënshkruan kontratat e punës dhe punës me honorar sipas planit të aprovuar afarist programor të RTK-së, në bazë të autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Kushtet që duhen plotësuar:

- Kualifikim superior profesional në drejtimin juridik apo në menaxhim biznesi;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave apo fushave të tjera relevante (Përparësi kanë kandidatët me përvojë më të gjatë);
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë dhe më gjerë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aftësi udhëheqëse dhe komunikuese;
- Standard të lartë të gjuhës shqipe në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës serbe dhe të gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Aftësi për caktimin e prioritetëve dhe për të punuar në mënyrë efektive nën presion dhe punë ekipore;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Njohuri e programeve MS Word, Excel dhe të tjera;
- Aftësi për të bashkëpunuar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
- Përkushtim ndaj shërbimit publik të transmetimeve

Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:

- të jenë qytetar të Kosovës, të regjistruar sipas dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës;
- të mos kenë qenë të dënur për ndonjë vepër penale dhe që të mos gjenden aktualisht nën hetim;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi;
- të mos kenë asnjë angazhim tjetër shtesë të punës jashtë këtij vendi të punës;

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- një CV,
- një kopje të letërnjoftimit,
- një letër motivuese,
- tri referenca,
- dëshmitë e kualifikimit,
- dëshmi që nuk është nën hetim të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit, si dhe aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga web faja e RTK-së, www.rtklive.com

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 09.11.2020 në orën 16:00.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Na osnovu člana 35 Zakona o Radio Televiziji Kosova Br. 04/L-046, ponovo-objavljuje:

KONKURS

Za popunjavanje pozicije:

Rukovodilac Zajedničkih Službi Radio Televizije Kosova

Rukovodilac Zajedničkih Službi:

- Treba biti osoba sa velikim iskustvom rukovođenja medijima ili sličnim relevantnim poljima;
- Treba biti državljanin Kosova i sa stalnim boravkom na Kosovu;
- Rukovodilac Zajedničkih Službi imenuje se od strane Borda Direktora, na osnovu predhodnog predloga Generalnog Direktora RTK;

Glavni zadaci i odgovornosti:

- Planira, organizuje, nadgleda i rukovodi proces rada Zajedničkih Službi;
- Sprovodi politike RTK-a definisanim zakonom, Statutom i od strane Upravnog Odbora RTK-a;
- Aktivno učestvuje u implementaciji strategije razvoja RTK-a i nadzire ostvarivanja dugoročnih i kratkoročnih planova;
- Priprema godišnji izveštaj za Zajedničke Službe u okviru poslovnog plana uključujući i ostvarenje plana ljudskih resursa sa obrazloženjem;
- Obezbeđuje redovne informacije Generalnom direktoru o finansijskoj situaciji, posebno o prekoračenju troškova u posebnim budžetskim linijama i eventualnom smanjenju prihoda;
- Proverava primenu RTK finansijskog plana, posebno u oblasti novih investicija;
- Odgovoran-a je za finansijske strategije i njene primene;
- Parafira (stavlja inicijale) ugovore iz oblasti novih investicija;
- Potpisuje dokumenta vezana za rad i poslovanje sektora;
- Prati primenu kompjuterskog sistema u oblasti finansija;
- Prati i koordinira rad pravne službe i regulativne politike RTK-a i vodi brigu o zakonitosti odluka, ugovora i drugih akata;
- Priprema godišnji finansijski plan koji je deo poslovnog plana RTK programa;
- Zajedno sa ostalim članovima rukovodstva on / ona priprema planove za obrazovanje, stručno usavršavanje i obučavanje zaposlenih;
- Održava redovne godišnje sastanke sa njegovim / njenim saradnicima;
- Prati razvoj budućeg RTK osoblja sa perspektivom ("ljudski resursi");
- Priprema i potpisuje ugovore o zapošljavanju i honorarne ugovore prema odobrenom planu rada RTK-a na osnovu ovlašćenja Generalnog direktora;

Za svoj rad izveštava i odgovara Generalnom Direktoru Radio Televizije Kosova.

Uslove koje treba ispuniti:

- Vrhunsku profesionalnu kvalifikaciju u pravnom smeru ili poslovnom menadžmentu;
- Najmanje 5 godine iskustva u rukovođenju medijama i ostalim relevantnim poljima (Prednost imaju kandidati sa dužim iskustvom);
- Da je osoba sa visokim profesionalnim i moralnim integritetom;
- Da ima izuzetno znanje medijskog spektra na Kosovu, Regiji i šire;
- Dokazane sposobnosti u organizovanju, rukovođenju i planiranju;
- Sposobnost rukovođenja i komunikacije;
- Visoki standard Albanskog jezika, govornog i pisanog;
- Odlično poznavanje Srpskog i Engleskog jezika, govornog i pisanog;
- Sposobnost za određivanje prioriteta i rada na efikasan način pod pritiscima i ekipni rad;
- Nepripadnost političkim partijama;
- Poznavanje programa MS Word, Excel i ostalo;
- Sposobnost za timski rad sa odmerenošću i sa osetljivošću sa kolegama i strankama;
- Posvećivanje oko javnog servisa emitovanja.

Zainteresovani kandidati za ove pozicije treba:

- da su državljanin Kosova, registrovani pod zakonskim odredbama Republike Kosova;
- da nisu osuđivani za krivična dela i da trenutno nisu pod istragom;
- da nemaju preuzete obaveze, biznise, što se može smatrati sukobom interesa;
- da ne budu dodatno radno angažovani izvan ovog radnog mesta;

Kandidati treba da dostave:

- jedan CV,
- kopija Lične Karte,
- pismo motivisanja,
- tri preporuke,
- dokazi o kvalifikaciji
- dokaz da nije pod istragom, (ne starije od mesec dana od dana apliciranja), kao i
- Molba/aplikacija, koja se može uzeti od web stranice RTK, www.rtklive.com.

Kompletna dokumentacija se u elektronskom formatu, skenirana, šalje na email adresu: konkurs@rtklive.com, do 09.11.2020. u 16:00h.

Prihvataju se samo prijave i dokumentacija predati elektronskim putem.

Aplikacije dostavljene sa zakašnjenjem se neće prihvatiti.

Nekompletirane aplikacije neće se uzeti u obzir.



Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohem*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaqshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.



Sh. B. Armagedoni

4⁹⁹ €

Linga e heshtjes • Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES

(poezi)



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrare. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema*

kadareane. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi


Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuara e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.

Dr. Arben Fetosbi



4⁹⁹ €

Triptikon arbëresh • Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)

-  **S. GIORGIO ALB.**
Mbuzati
-  **VACCARIZZO ALB.**
Vakarici
-  **S. COSMO ALB.**
Strighari
-  **MACCHIA ALB.**
Maqi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

